

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI MJEKËSISË, TIRANË**

D I S E R T A C I O N

**I P A R A Q I T U R N G A:
A J M O N E T R O S H A N I**

PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE

“D O K T O R”


T E M A

**SËMUNDSHMËRIA RESPIRATORE NEONATALE NË
SECTIO CAESAREA ELEKTIVE**

**Dizertanti
Ajmone Troshani**

**Udhëheqësi Shkencor
Prof. Evda Vevecka**

Tiranë, 2021



UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI MJEKËSISË, TIRANË

DISERTACION

I PARAQITUR NGA:
AJMONE TROSHANI

PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE
“DOKTOR”

MBROHET NË DATË: /..... / PARA JURISË:

- PROF. ANILA GODOKRYETAR
- PROF. MIRA KOLA.....ANËTAR (OPONENT)
- PROF. As. LUAN XHELILAJANËTAR (OPONENT)
- PROF. AFERDITA MANAJ.....ANËTAR
- PROF. ELIZANA PETRELA.....ANËTAR

FALENDERIME

Deshiroj te falenderoj e te shpreh mirenjohjen time per udheheqesin e doktoratures Prof.Evda Vevecka për udhëzimet dhe mbështetjen shkencore të dhënë gjatë studimit, si dhe për ndihmesën e pakursyer në realizimin e Doktoraturës .

Falenderoj gjithashtu Spitalin Universitar Obstetrik - Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldine”, Tiranë, i cili më dha mundësi dhe mbështetje për të marrë dhe shfrytëzuar të dhënat për realizimin e këtij punimi Dokorate.

Nuk mund të le pa permendur atë që më ndihmoi për metodologjinë dhe përpunimin e të dhenave, Dr. Ervin Toci, pa ndihmën e të cilit ky punim nuk do ishte ky që është.

Dhe në fund, por jo nga rëndësia, falenderoj familjen time, të cilës i kam marrë shumë kohë dhe të gjithë më kane mbështetur pa rezerva. Falë durimit dhe mirekuptimit të tyre, sot jam doktorante në shkencën e mrekullueshme të mjekësisë.



DEKLARATE

Punimi i kësaj teze është origjinal dhe pronë e autores.

Ky punim nuk është paraqitur në ndonjë shkallë kualifikimi, në ndonjë universitet apo institucion tjetër, nuk është pasqyruar në ndonjë botim brenda apo jashtë vendit

Deklaruesi
Ajmone Troshani

Tabela e Përmbajtjes

| | |
|--|-----------|
| HYRJA..... | 13 |
| 1.1 Historiku..... | 13 |
| 1.2 Ndryshimi i mendesise per menyren e lindjes | 14 |
| 1.3 Klasifikimi i Sectio caesarea – <i>Elektive dhe I emergjences</i> | 15 |
| 1.4 Zgjedhja e nenes : Too Posh to Push | 15 |
| 2. FIZIOLOGJIA E TRANZICIONIT NGA JETA INTRAUTERINE NE ATE EXTRAUTERINE | 18 |
| 2. 1. Hyrje..... | 18 |
| 2.2. Adaptimi Pulmonar | 19 |
| 2.2.1. Likidi pulmonar fetal | 19 |
| 2.2.2 Frymemarrja ne lindje..... | 19 |
| 2.2.3 .Surfaktanti dhe adaptimi pulmonar..... | 20 |
| 3. SEMUNDSHMERIA RESPIRATORE TE FEMIJET E LINDUR ME SCE..... | 22 |
| 3.1 Perse sectio caesarea elektive paraqet nje rrezik te larte per neonatin ?..... | 22 |
| 3.2. Roli i likidit te mbetur ne mushkerite e fetusit ne semundshmerine neonatale respiratore dhe si pastrohet likidi fetal nga mushkeria e bebit | 23 |
| 3.3 Vlerësimi i një te porsalinduri me probleme respiratore..... | 25 |
| 3.4 Problemet me ndryshimet në aparatn respirator dhe në qarkullimin tranzitor..... | 27 |
| 3.4.1 Takipnea Tranzitore Neonatale | 27 |
| 3.4.2 Detresi Respirator | 28 |
| 3.4.3 Hipertensioni Persistent Pulmonar Neonatal | 30 |
| 3.4.3.1 Etiologjia dhe Fispatologjia e PPHN | 30 |
| 3.4.3.2 Diagnoza | 32 |
| 3.4.3.3 Trajtimi..... | 33 |
| 4. QELLIMI DHE OBJEKTIVAT E STUDIMIT | 34 |
| 4.1. Qellimi | 34 |
| 4.2. Objektivat..... | 34 |
| 5. MATERIALI DHE METODOLOGJIA | 37 |
| 5.1 Subjektet e studiuara | 37 |
| Variablat e studiuar : | 37 |
| 5.2. Perpunimi statistikor | 38 |

| | |
|--|-----------|
| 6. REZULTATET dhe DISKUTIMET | 40 |
| 6.1. REZULTATET | 40 |
| 6.1.1 Të dhëna të përgjithshme për subjektet në studim..... | 40 |
| 6.1.2. Te dhena te lidhura me SEMUNDSHMERINE RESPIRATORE NEONATALE | 45 |
| 6.1.2.1 Incidenca e takipnesë tranzitore neonatale (TTN), sipas mënyrës së lindjes, 2011-2016 | 45 |
| 6.1.2.3 Incidenca e hipertensionit pulmonar gjatë periudhës 2011-2016 | 47 |
| 6.1.2.4 Kohëzgjatja mesatare e TTN, HPP dhe shtatzënisë gjatë periudhës 2011-2016 | 48 |
| 6.1.2.5 Të dhëna lidhur me antibiotikoterapinë dhe kohëzgjatjen e qëndrimit në spital | 49 |
| 6.1.2.6 Kohëzgjatja e shtatzënisë dhe sëmundshmëria respiratore neonatale..... | 51 |
| 6.1.2.6.1 Takipnea tranzitore neonatale sipas kohëzgjatjes së shtatzënisë. | 51 |
| 6.1.2.6.2 Detresi respirator sipas kohëzgjatjes së shtatzënisë..... | 52 |
| 6.1.2.6.3 Hipertensioni pulmonar sipas kohëzgjatjes së shtatzënisë..... | 53 |
| 6.1.2.7 Lidhja e kohëzgjatjes së shtatzënisë me sëmundshmërinë respiratore | 54 |
| 6.1.2.7.1 Lidhja e kohëzgjatjes së shtatzënisë me takipnenë tranzitore neonatale | 54 |
| 6.1.2.7.2 Lidhja e kohëzgjatjes së shtatzënisë me detresin respirator të bebeve | 56 |
| 6.1.2.7.3 Lidhja e kohëzgjatjes së shtatzënisë me hipertensionin pulmonar | 58 |
| 6.1.2.8. Lidhja e kohëzgjatjes së shtatzënisë me pranimin në reanimacionin neonatal | 60 |
| 6.1.2.9 Lidhja e kohëzgjatjes së shtatzënisë me nevojën për terapi me oksigjen në reanimacionin neonatal | 62 |
| 6.1.2.10 Lidhja e kohëzgjatjes së shtatzënisë me sëmundshmërinë respiratore | 65 |
| 6.1.2.11 Lidhja e kohëzgjatjes së shtatzënisë me sëmundshmërinë respiratore | 67 |
| 6.2 DISKUTIME | 72 |
| 7. PERFUNDIME..... | 78 |
| 8. REKOMANDIME | 80 |
| 9. REFERENCA..... | 81 |

TABELA E GRAFIKËVE

| | |
|---|----|
| Grafiku 1. Shpërndarja e lindjeve unike sipas viteve, 2011-2016 | 40 |
| Grafiku 2. Shpërndarja e lindjeve unike sipas mënyrës së lindjes, 2011-2016 | 41 |
| Grafiku 3. Radha e lindjes aktuale sipas mënyrës së lindjes, 2011-2016 | 43 |
| Grafiku 4. Kohëzgjatja e shtatzënisë sipas mënyrës së lindjes, 2011-2016..... | 44 |
| Grafiku 5. Incidenca (%) e takipnesë tranzitore neonatale (TTN) tek bebet, sipas mënyrës së lindjes, 2011-2016 | 45 |
| Grafiku 6. Incidenca (%) e detresit respirator tek bebet, sipas mënyrës së lindjes, 2011-2016 | 46 |
| Grafiku 7. Incidenca (%) e hipertensionit pulmonar tek bebet, sipas mënyrës së lindjes, 2011-2016 | 47 |
| Grafiku 8. Kohëzgjatja mesatare e qëndrimit në spital sipas mënyrës së lindjes, gjatë periudhës 2011-20 | 50 |
| GRAFIKU 9. Incidenca (%) e takipnesë tranzitore neonatale , sipas kohëzgjatjes së shtatzënisë, 2011-2016 | 51 |
| Grafiku 10. Incidenca (%) e detresit respirator tek bebet, sipas kohëzgjatjes së shtatzënisë, 2011-2016..... | 52 |
| Grafiku 11. Incidenca (%) e hipertensionit pulmonar tek bebet, sipas kohëzgjatjes së shtatzënisë, 2011-2016 | 53 |
| Grafiku 12. Raporti i gjasave (OR) të takipnesë tranzitore neonatale (TTN), sipas kohëzgjatjes së shtatzënisë, 2011-2016 (Modeli 2)..... | 54 |
| Grafiku 13. Raporti i gjasave (OR) të detresit respirator, sipas kohëzgjatjes së shtatzënisë, 2011-2016 (Modeli 2) | 56 |
| Grafiku 14. Raporti i gjasave (OR) të hipertensionit pulmonar, sipas kohëzgjatjes së shtatzënisë, 2011-2016 (Modeli 2) | 58 |
| Grafiku 15. Raporti i gjasave (OR) të pranimit të bebes në reanimacionin neonatal, sipas kohëzgjatjes së shtatzënisë, 2011-2016 (Modeli 2) | 61 |
| Grafiku 16. Raporti i gjasave (OR) të nevojës për terapi me oksigjen të bebes në reanimacionin neonatal, sipas kohëzgjatjes së shtatzënisë, 2011-2016 (Modeli 2)..... | 63 |
| Grafiku 17. Përqindja e bebeve që i'u bë reanimimi në sallën e lindjes, sipas mënyrës së lindjes, 2011-2016 | 70 |
| Grafiku 18. Përqindja e bebeve që morën terapi me Oksigjen në sallën e lindjes, sipas mënyrës së lindjes, 2011-2016..... | 70 |
| Grafiku 19. Përqindja e bebeve të transferuar në reanimacionin neonatal, sipas mënyrës së lindjes, 2011-2016 | 71 |
| Grafiku 20. Përqindja e bebeve që kanë marrë terapi me Oksigjen në reanimacionin neonatal, sipas mënyrës së lindjes, 2011-2016..... | 71 |

TABELA E TABELAVE

| | |
|---|----|
| Tabelë 1. Përmbledhja e risqeve dhe benefiteve të lindjes me sectio caesarea, nga konferenca konsensusit të shkencës e mbajtur nga NHS (CDMR) | 17 |
| Tabelë 2. Semundshmeria Respiratore Neonatale | 26 |
| Tabelë 3. Numri i lindjeve gjatë periudhës 2011-2016..... | 40 |
| Tabelë 4. Shpërndarja e bebeve të lindura sipas mënyrës së lindjes..... | 41 |
| Tabelë 5. Shpërndarja e mënyrës së lindjes sipas viteve të studimit | 42 |
| Tabelë 6. Radha e lindjes aktuale sipas mënyrës së lindjes | 42 |
| Tabelë 7. Pesha në lindje sipas mënyrës së lindjes gjatë periudhës 2011-2016 | 43 |
| Tabelë 8. Kohëzgjatja mesatare e TTN, HPP dhe shtatzënisë sipas mënyrës së lindjes gjatë periudhës 2011-2016..... | 44 |
| Tabelë 9 . Incidenca e takipnesë tranzitore neonatale gjatë periudhës 2011-2016..... | 45 |
| Tabelë 10 . Incidenca e detresit respirator gjatë periudhës 2011-2016..... | 46 |
| Tabelë 11. Incidenca e hipertensionit pulmonar gjatë periudhës 2011-2016 | 47 |
| Tabelë 12. Kohëzgjatja mesatare e TTN, HPP dhe shtatzënisë gjatë periudhës 2011-2016 | 48 |
| Tabelë 13. Aplikimi i antibiotikoterapisë sipas mënyrës së lindjes | 49 |
| Tabelë 14. Kohëzgjatja mesatare e qëndrimit në spital sipas mënyrës së lindjes, gjatë periudhës 2011-2016 | 49 |
| Tabelë 15. Takipnea tranzitore neonatale sipas kohëzgjatjes së shtatzënisë. | 51 |
| Tabelë 16. Detresi respirator sipas kohëzgjatjes së shtatzënisë | 52 |
| Tabelë 17. Hipertensioni pulmonar sipas kohëzgjatjes së shtatzënisë..... | 53 |
| Tabelë 18. Lidhja e gjasave për të zhvilluar takipnenë tranzitore neonatale me kohëzgjatjen e shtatzënisë – Raporti i gjasave (OR) nga Regresioni Logjistik Binar | 54 |
| Tabelë 19. Lidhja e gjasave për të zhvilluar takipnenë tranzitore neonatale me kohëzgjatjen e shtatzënisë, sipas mënyrës së lindjes – Raporti i gjasave (OR) nga Regresioni Logjistik Binar..... | 55 |
| Tabelë 20. Lidhja e gjasave për të zhvilluar detres respirator me kohëzgjatjen e shtatzënisë – Raporti i gjasave (OR) nga Regresioni Logjistik Binar | 56 |
| Tabelë 21. Lidhja e gjasave për të zhvilluar detres respirator me kohëzgjatjen e shtatzënisë, sipas mënyrës së lindjes – Raporti i gjasave (OR) nga Regresioni Logjistik Binar | 57 |
| Tabelë 22. Lidhja e gjasave për të zhvilluar hipertension pulmonar me kohëzgjatjen e shtatzënisë – Raporti i gjasave (OR) nga Regresioni Logjistik Binar | 58 |
| Tabelë 23. Lidhja e gjasave për të zhvilluar hipertension pulmonar me kohëzgjatjen e shtatzënisë, sipas mënyrës së lindjes – Raporti i gjasave (OR) nga Regresioni Logjistik Binar | 59 |
| Tabelë 24. Lidhja e gjasave për t’u pranuar në reanimacionin neonatal me kohëzgjatjen e shtatzënisë – Raporti i gjasave (OR) nga Regresioni Logjistik Binar | 60 |
| Tabelë 25. Lidhja e gjasave për t’u pranuar në reanimacionin neonatal me kohëzgjatjen e shtatzënisë, sipas mënyrës së lindjes – Raporti i gjasave (OR) nga Regresioni Logjistik Binar..... | 61 |
| Tabelë 26. Lidhja e gjasave për për terapi me oksigjen në reanimacionin neonatal me kohëzgjatjen e shtatzënisë – Raporti i gjasave (OR) nga Regresioni Logjistik Binar | 62 |
| Tabelë 27. Lidhja e gjasave për terapi me oksigjen në reanimacionin neonatal me kohëzgjatjen e shtatzënisë, sipas mënyrës së lindjes – Raporti i gjasave (OR) nga Regresioni Logjistik Binar..... | 64 |

| | |
|---|----|
| Tabelë 28. Lidhja e gjasave të sëmundshmërisë respiratore (TTN, detres respirator, HPP) me kohëzgjatjen e shtatzënisë – Raporti i gjasave (OR) nga Regresioni Logjistik Binar | 65 |
| Tabelë 29. Lidhja e gjasave të sëmundshmërisë respiratore (TTN, detres respirator, HPP) me kohëzgjatjen e shtatzënisë, sipas mënyrës së lindjes – Raporti i gjasave (OR) nga Regresioni Logjistik Binar | 66 |
| Tabelë 30. Lidhja e gjasave të sëmundshmërisë respiratore (TTN, detres respirator, HPP) me mënyrën e lindjes – Raporti i gjasave (OR) nga Regresioni Logjistik Binar | 67 |
| Tabelë 31. Lidhja e gjasave të sëmundshmërisë respiratore (TTN, detres respirator, HPP) me kohëzgjatjen e shtatzënisë, sipas mënyrës së lindjes – Raporti i gjasave (OR) nga Regresioni Logjistik Binar | 68 |
| Tabelë 32. Rezultati i testit Apgar në minutën 1 dhe 5 pas lindjes gjatë periudhës 2011-2016 | 69 |
| Tabelë 33. Shpërndarja e komplikacioneve të ndryshme sipas mënyrës së lindjes | 69 |

Tabela e Figurave

| | |
|--|----|
| Figura 1. Sistemi kardiovaskular neonator | 18 |
| Figura 2. Skema që përmbledh funksionin e kanaleve të Na amiloride-sensitivë në mushkeri | 24 |
| Figura 3. Radiografia pulmonare e neonatit me takipnea tranzitore neonatale; | 28 |
| Figura 4. Rografi pulmonare e të porsalindurit me Detres Respirator | 29 |
| Figura 5. Etiologjia dhe Fispatologjia e HPP | 32 |

SHKURTIMET

SC - Sectio caesarea

SCE - Sectio caesarea elektive

TTN - Takipnea Tranzitore Neonatale

DR - Detres respirator

PPHN - Hipertension Persistent Pulmonar Neonator

CPAP - presion të vazhdueshëm pozitiv të rrugëve të frymëmarrjes

PEEP - Presioni pozitiv ne fund te ekspirimit

OBSH - Organizata boterore e shendetesise

UNICEF - United national international Children's emergency fund

UNFPA - United Nations Population Fund

USAID - United State Agency International Development

NHS - National Institutes of Health State-of-the-Science

TEF - Fistula Tracheoesophageale

PFO - foramen ovale apertum

PDA - ductus arteriosus

PCO₂- Presioni i dioksidit te karbonit

PO₂ - Presioni i oksigjenit

NRP - Programi i reanimimit neonator

ABSTRAKTI

Qellimi Vleresimi i semundshmerise respiratore neonatale ne SCE si dhe rendesia e kohes se kryerjes se SCE.

Metodologjia Ne studim u perfshine bebet e lindura me SCE ne moshe shtatzanie nga 37 0+6 javesh deri 40 0+6 javesh ne SUOGj 'Mbretresha Geraldine' nga 1 Janar 2011-1 Janar 2017 duke perjashtuar bebet e lindura me anomali kongenitale, shtatzanite multiple, apo shtatzanite problematike(IUGR, diabet gestacional, preeklampsi). Ne Semundshmerine respiratore u perfshine takipneone tranzitore neonatale, Detresin Respirator, dhe hipertensionin persistent pulmonar te neonatit .

Rezultatet 4290 femije kane lindur me SCE nga java e 37+0 e me pas e shtatzanise e te krahasuar me lindje vaginale si dhe seksio caesarea emergjente vihet re nje risk i larte i semundshmerise respiratore tek femijet e lindur me SCE ne javen 37.0+6 te shtatzanise (raporti i gjasave 4.5 intervali i kofidences 95% 3.3 ne 6.3), javen e 38.0+6 (2.7 , 1.9 ne 3.6), dhe javen e 39.0+6 (2.1, 1.6 ne 3.0). Kemi nje rritje te incidences te transferimit ne RTI me zvogelimin e moshes gestacionale ne lindjet ne term.

Konkluzioni Femijet e lindur me SCE ne term kane nje risk me te larte per te shfaqur semundshmeri respiratore krahasuar me ata te lindur ne ruge vaginale. Nje renie e dukshme e Semundshmerise Respiratore vihet re nese SC performohen pas javes se 39 + 0 te shtatzanise.

Fjalet kyce Sectio caesarea elektive,semundshmeria respiratore neonatale, takipnea tranzitore neonatale, detres respirator, hipertensioni pulmonar.

ABSTRACT

Aim To investigate the association between ECS and neonatal respiratory morbidity and the importance of timing of ECS

Methods Cohort study with collected data of all ECS on mothers with a gestational age of 37+0 weeks and more were performed in our Hospital 1 January 2011-1 January 2017. Multiple pregnancies, fetuses with congenital anomalies, intrauterine deaths, preeclampsia gestacional diabet were excluded. Primary outcome measures of neonatal respiratory morbidity included transient tachypnea of newborn, respiratory distress syndrome, persistent pulmonary hypertension of newborn.

Results 4290 infants were delivered by elective caesarean section at 37+0 and then after compared with newborns from vaginal delivery, and emergency caesarean section an increased risk of respiratory morbidity was found for infants delivered by elective caesarean section at 37.0+6 weeks' gestation (odds ratio 4.5 95% confidence interval 3.3 to 6.3), 38.0+6 weeks' gestation (2.7 , 1.9 to 3.6), and 39.0+6 weeks' gestation (2.1, 1.6 to 3.0). Also increasing the incidence of admission to the NICU with decreasing gestational age at term birth below the 39 weeks of gestation

Conclusions: Infants born by elective caesarean delivery at term are at increased risk for developing respiratory disorders compared with those born by vaginal delivery. A significant reduction in neonatal respiratory morbidity would be obtained if elective caesarean delivery were performed after 39 + 0 gestational weeks of pregnancy.

Keywords Elective caesarean section, neonatal respiratory morbidity ,neonatal transient tachypnea , Respiratory distress syndrome, pulmonary hypertension

HYRJA

Një nga sfidat më të rëndësishme me të cilat përballlet i porsalinduri është periudha shumë shkurtër tranzitore gjatë të cilës mushkëritë e tij nga të mbushura me uje duhet të pastrohen dhe të mbushen me ajër. Sëmundshmëria respiratore si pasojë e pamundësisë së pastrimit të mushkërisë nga likidi fetal nuk është e pazakontë të të posalindurit, por në bebet e lindura me sectio caesarea elektive (SCE) pa filluar aktiviteti i lindjes mund të jetë veçanërisht problematike. Rritja e shpeshtësisë së lindjes me sectio caesarea sikurse në të gjithë botën edhe tek ne, ka ndikuar në shëndetin publik dhe koston shëndetësore si pasojë e rritjes së sëmundshmërisë në bebet e lindura me SCE. Ndërkohë që asfiksia në lindje, aspirimi i mekoniumit dhe traumat janë më të pakta në lindjet me SCE krahasuar me lindjen vaginale; rreziku i detresit respirator si pasojë e takipnese tranzitore të të posalinduri, deficitit në surfaktant dhe hipertensioni pulmonar janë rritur.

Lidhur me sa parashtruam me sipër studimi tek ne i sëmundshmërisë respiratore të bebet e lindura me SCE krahasuar me sëmundshmëri respiratore të bebeve të lindura nepermjet rrugës vaginale ka për qëllim të vlerësojë situatën në maternitetin tonë si dhe të ndikojmë në pakësimin e rekomandimeve për këtë mënyrë lindje duke pasur qasje kështu jo vetëm në favor të shëndetit të bebeve, por edhe për të pakësuar shpenzimet shëndetësore.

1. Te dhena teorike mbi lindjen me sectio caesarea elektive dhe sëmundshmërinë respiratore neonatale

1.1 Historiku

Sectio caesarea është një procedurë operative, e cila ka për qëllim lindjen e fëmijës nëpërmjet prerjes abdominale dhe murit të mitres.

Sectio caesarea ka qenë pjesë e kulturës njerëzore që në kohët e lashta dhe ekzistojnë gojedhena të kësaj procedure si në kulturen perendimore dhe atë jo perendimore që rezultojnë në nëna të gjalla si dhe lindje të pasardheshve⁽¹⁾

Akoma historia e hershme e sectio caesarea mbetet e zhytur në mite dhe është me saktësi të dyshimte. Në kohët e lashta kjo procedurë, kryhej vetëm pas vdekjes së gruas.

Në vitin 1610 u krye një sectio-caesarea në një grua të gjallë, gjë që më vonë u përsërit shpesh, por vdekshmëria amtare ishte shumë e lartë.^(1,2)

Gjithashtu edhe origjina e fjalës "caesarean" ka pësuar ndryshime me kalimin e kohës.

Mendohet, sipas legjendës, Julius Cesar, ka lindur në këtë mënyrë dhe për pasojë edhe procedura është bërë e njohur si operacion cezarian pavarësisht disa rrethanave të cilat nuk e mbështetin shpjegimin në fjalë. Nëna e Cesarit jetoi edhe shumë vjet pas lindjes së tij në vitin 100 p.e.s, ndërkohë që deri në shekullin e 17-të ky lloj operacioni ishte pandryshueshmërisht fatal.^(1,2)

Operacioni, i realizuar si në të gjallë ashtu edhe në të vdekur, nuk përmendet nga ndonjë dokument mjekësor përpara Mesjetës. Detajet historike të origjinës së emrit të cesarit janë gjetur në monografinë nga Picrell.

Shpjegimi i dytë i emrit të operacionit cezarian rrjedh nga ligji roman që supozohet që u ofrua në shekullin e 8 p.e.s, nga Numa Pompilius, që urdhëroi që procedura të bëhej tek gratë në javët e fundit të shtatzanisë me shpresën e shpëtimit të fëmijës së tyre. Ky rregull ose ligj mbretëror që më vonë u bë lex caesarea nga perandoret dhe vetë operacioni u bë i njohur si operacioni cezarian.^(1,2)

Shpjegimi i tretë i fjalës cezariane ka ardhur nga mesjeta nga fjala latine caedere që do të thotë *prerje*. Ky shpjegim ngjan më llogjik, por ekzaktesisht kur u aplikua për herë të parë ky operacion, gjithcka ishte e paqartë, sepse prerja vjen nga fjala latine sexo që gjithashtu nënkupton me pre. Në shekujt në vazhdim vihej re një mortalitet i theksuar amtar. Gjatë të fundit të viteve 1800 asnjë nuk i mbijetoi lindjes cezariane, por më 1879 Harris shënoi se lindjet cezariane ishin aktualisht më të suksesshme kur u perfomuan nga vetë pacientët ose kur abdomeni hapej nga brirët e demit! !!!!

Më vonë, një pjesë e rëndësishme e modifikimeve u rekomandua nga Kerr me 1926, ku u preferua më shumë mënyra transverse sesa incizioni uterin longitudinal.^(2,3)

1.2 Ndryshimi i mendësisë për mënyrën e lindjes

Qëllimi fillestar i kryerjes së sectio caesarea ishte shpëtimi i jetës së femijes, duke qenë se, mortaliteti i nënës ishte shumë i madh.^{1,2}

Lindja me sectio caesarea është procedura me e zakonshme kirurgjikale ne pothuajse gjitha spitalet e USA. Ne rrjedhen e viteve me përmiresimin e teknikave dhe mjeteve ne dispozicion frekuenca e lindjes nepermjet seksio caesarea erdhi duke u rritur, nga 20.7 % te te gjitha lindjeve ne 1996 ne 32.8 % ne vitin 2011.⁽³⁾

Në krahasimet ndërkombetare frekuenca e SC ne USA eshte më e larte se ajo e vendeve te ngjashme pa benefite klinike te matshme.⁽⁴⁾

Sipas të dhënave nga OBSH në bashkëpunim me UNICEF, USAID, UNFPA dhe ministrinë e shëndetësisë (Albania Demographic and Health Survey 2008-2009| Mars 2010 fq 130); për vendin tonë, rezulton që përgjatë 5 viteve, 2005-2010, 19% e lindjeve janë realizuar me sexio-cezarea. Kjo rritje ka patur nje sere arsyes si rritja e moshës në të cilin grate lindin, lindjet me shume fëmije nga përdorimi i fertilizimit artificial si edhe frika e mjekëve dhe nënave nga rreziqet e lindjes në rrugë natyrale vaginale.⁽⁵⁾

OBSH rekomandon qe lindjet me sectio caesarea nje perqindje jo me shume 10 % per nje pritshmeri semundshmerie optimale tek nena e I porsalinduri.

Bazuar ne te dhena te disponueshme dhe duke perdorur metoda nderkombetare te te vleresimit te evidencave OBSH vendosi qe Sectio cezariane janë efektive në shpëtimin e jetës së nënës dhe fëmijës, por vetëm kur ato janë të nevojshme për arsye mjekësore si dhe qe në nivel të popullsisë, përqindjet e seksioneve cezariane më të larta se 10% nuk shoqërohen me ulje te morbiditetit e mortalitetit të nënës dhe të porsalindurit.⁽⁶⁾

M.gj.th. te dhenat mbi rritjen e frekuences se lindjes nepermjet sectio cezarea variojne sipas rajoneve rreth 35 % e rasteve te zgjedhjes se kesaj menyre lindje i takon nenave qe kane patur tashme me pare nje lindje me sectio cezarea.

1.3 Klasifikimi i Sectio caesarea – *Elektive dhe I emergjences*

Ndermjet arsyeve te shumta per kryerjen e sectio caesarea vete kirurgët obsteter I klasifikojne ne 2 grupe ; si S.C. emergjente ose si S.C elektive .

S.C.emergjente (jo e planifikuar) përcaktohen si sectio caesarea të performuara në mënyrë emergjente për të mirën shëndetësore të nënës apo atë fetale pas fillimit të aktivitetit te lindjes.⁷

Në të kundërt sectio caesarea elektive (E planifikuar) përcaktohen si sectio caesarea e performuar përpara fillimit te aktivitetit te lindjes.⁷ Ka shumë arsye përse I perket lindjeve me sectio caesarea te planifikuara duke perfshire prezantimin podalik, problem me lindjet e meparshme vaginale dhe sectio caesarea të mëparshme.⁸

Përvec indikacioneve medikale per sectio caesarea të planifikuara ka edhe disa arsye jo mjekësore si konvencienca ne skedulimin e lindjes , frika e problemeve te dyshemese se pelvisit pas nje lindje per via vaginalis dhe mungesë e besueshmërisë pas nje lindjeje per via vaginalis.⁹ Sectio caesarea te planifikuara sidomos ato te ndërmarra për një arsye jo mjekësore vazhdojnë të jenë nën debat te vazhdueshem ,duke rritur kështu nevojën per te peshuar rreziqet potenciale te kirurgjise me te drejten e nënës per të ndërmarre vendime te informuara përse I përket përvojës së tyre te lindjes.¹⁰ Këto sectio janë të ndërlidhura me frazën “ too push to push “.

Ashtu si sectio caesarea te planifikuara arsyet per sectio caesarea te paplanifikuara jane te shumta, megjithese ne keto raste vendimi per kryerjen e sectio caesarea behet pas fillimit të aktivitetit te lindjes . Ndër arsyet përmendim shendetin e nenës (Preklampsi), shendetin fetal (vuajtja fetale, prezantimi jo I mire I fetusit , anormalitete placentare qe perfshijne placenten previa) dhe probleme gjate lindjes (dystocia)^{11,12,13}

1.4 Zgjedhja e nenës : Too Push to Push

Megjithese e vështirë për ta percaktuar saktësisht, është vlerësuar se rreth 4% deri në 18% të të gjitha lindjeve me sectio caesarea në mbarë botën bëhen me kërkesën e nënës (e perkufizuar si lindje primare me sectio cezarea pa aktivitet lindjeje dhe ne mungese te indikacioneve amtare apo fetale¹⁴ .

Në Shtetet e Bashkuara, lindja me sectio caesarea me kërkesën e nënës eshte midis 2.6 dhe 5.5%.²³
¹⁵

Ne nje konference te mbajtur nga NHS me teme “*Lindjet me sectio caesarea me kerkese te nenës*”; një panel ekspertësh ndërmorrën rishikimin e literaturës së disponueshme si dhe opinionin e ekspertëve per këtë temë. Ata përsëriten faktin se kërkesa e nënës gjithnjë e më shumë luan një rol të rëndësishëm në vendimet e obstetërve për të kryer sectio cezarea.¹⁶

Shumë mjekë obstetër besojnë që zgjedhja për të lindur me sectio cezarea e shume personazheve vip si Madona, Kate Winslate, ..., te quajtura “Too Push to Push” ka ndikuar ne vendimin e nenave per te ndermarre sectio caesarea pa indikacion medikal.^(17,18) Organizata te tilla si Childbirth Connection përmes sondazheve kanë gjetur se vetëm 1 në 1600 gra të anketuara kanë planifikuar një sectio cezariane elektive dhe kërkesa e nënës per lindje me sectio cezarea pa indikacion mjeksor nuk eshte nje trend ne rritje dhe nuk eshte shkaku kryesor i rritjes së sectiove caesareane .^{19,20}

Përkundrazi një shkak më i rëndësishëm për rritjen e tyre është ndryshimit i praktikave të profesionistëve të mjekësisë dhe gatishmëria e tyre për të kryer sectio cezarea. Në të vërtetë gati një e katërta e nënave të anketuara të cilët u nënshtruan sectio cezariane, raportuan presionin e personelit mjekësor për të pasur një sectio cezarea.²¹ Shumica e pacientëve dhe personelit mjekësor të cilët preferojnë sectio cezariane mbi lindjen vaginale përmendin frikën e demtimeve perineale, duke përfshirë inkontinencën urinare apo atë anale, mos funksionimin seksual, dëmtimin e fetusit, kontrollin dhe komoditetin.²²

Nuk ka evidenca të mjaftueshme apo vetëm evidenca të dobëta që të flasin për rritjen e vdekshmërisë amtare gjatë SCE; ndonese vdekshmëria amtare sot është një dukuri e rrallë, por sidoqoftë që ka rritje të rrezikut për semundshmeri serioze të nënës.

Një sondazh i bërë në mjekët britanikë tregoi se pothuajse gjysma e obstetërve/obstetereve mendonin se grave duhet t'u ofrohet zgjedhja e mënyrës së lindjes dhe 33% e tyre parapëlqenin për vetë/ose bashkeshortet e tyre, lindjen nepermjet SCE.²³

Kjo zgjedhje bazohet në zvogëlimin e rrezikut të hemorragjisë postpartum, me pak stres për mundësinë e inkontinencës urinare, vdekshmërinë më të ulët fetale, shmangjen e mundësive se encefalopatisë hipoksike ishemike, apo të dëmtimit të pleksusit brachial.

Në tabelën 1 janë paraqitur në mënyrë të përbledhur përparësitë dhe rreziqet e lindjes me sectio cezarea. Sidoqoftë përderisa ende nuk kemi një mënyrë lindje që të sigurojë besim të plotë mbi mundësitë e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë minimale apo ndryshime të forta kulturore, ekonomike dhe mediko – legale kjo mënyrë lindje rrezikon të jetë një trend në rritje, dhe kërkesa e nënës për këtë lloj lindje do jetë gjithmone e rëndësishme.

Tabelë 1. Përmbledhja e risqeve dhe benefiteve të lindjes me sectio caesarea, nga konferenca konsensusit të shkencës e mbajtur nga NHS me teme “Lindje me sectio caesarea me kërkesë të nënës “ (CDMR).

| | Amtare | Neonatale |
|---|---|--|
| Evidenca me Cilesi mesatare Ne favor te lindjes vaginale Ne favor te lindjes SCE | Diteqendrim me i shkurter ne spital Risk me i ulet per hemoragji postpartum | Semundshmeri neonatale me e ulet |
| Evidenca me cilesi te dobet Ne favor te lindjes vaginale Ne favor te lindjes me SCE Sensitive ndaj paritetit dhe madhesise se familjes | Perqindja e infeksionit me e ulet Me pak komplikacione nga anestetiket Me pak placenta previa konsekuive Perqindje me e larte e ushqyerjes me gji Inkontinence urinare me afatshkurter komplikacione kirurgjikale me te pakta ne krahasim me S.C.te paplanifikuara Rupture uterine sekuente Histerektomi Numri i shtatzanive | Me pak prematuritet iatrogenic Qendrim me i shkurter ne spital Mortalitet fetal me i ulet Me pak IVH, asfiksi neonatale ,encefalopati ,demitim i pleksit brakial infeksion neonatal |
| Evidenca me cilesi te Dobet Asnjera nga menytrat e lindjes nuk ofron ndonjë avantazh për këto çështje | Vdekshmeri Fuksioni anorectal Fuksioni seksual Prolaps i organeve pelvike Lindje te tjara ne radhe | Vdekshmeri Rezultate afatgjata |
| <i>From Hibbard J, Torre MD Grand Rounds: When mom requests a caesarean. Contemporary OB/GYN:38, 2006,</i> | | |

2. FIZIOLOGJIA E TRANZICIONIT NGA JETA INTRAUTERINE NE ATE EXTRAUTERINE

2. 1. Hyrje

Periudha e tranzicionit nga jeta fetale ne te porsalindur eshte nje adaptim fiziologjik nder me komplekset ne pervojen humane. Te gjitha sistemet organore jane te perfshira ne kete tranzicion por adaptimi me imediat madhor eshte stabiliteti I frymemarrjes njekohesisht me ndryshimet ne presione si dhe ne qarkullim brenda sistemit kardiovaskular. Adaptim tjetër I rëndësishëm është ndryshimet që ndodhin ne funksionin endokrin, metabolik si dhe ne termogjeneze.

Lindjet ne ambientet spitalore rrisin vështirësitë për nje tranzicion normal te shumë fetuseve për shkak të frekuences se larte te sectio caesarea, lindjeve perpara fillimit te aktivitetit , shtrëngimit të shpejtë të kordonit dhe perdorimit te anestetikëve dhe analgjezikëve që lidhen me këto lindje ne ambiente spitalore. Rezultati neto është nevojat e shpeshta për të ndihmuar të porsalindurin ne periudhen e tranzicionit gjate lindjes . Pikerisht këto përbërës të periudhes se tranzicionit fetal do të rishikohen për lindjet preterm si dhe lindjet ne term .




Fig. 1. Sistemi kardiovaskular neonator

2.2. Adaptimi Pulmonar

2.2.1. Likidi pulmonar fetal

Përshtatja më e rëndësishme në lindje është fillimi i frymëmarrjes, por hapësirat ajrore të mushkërive fetale është i mbushur me likidin e mushkërive fetale.

Çfarë është likidi i mushkërive fetale dhe si pastrohet ai nga hapësirat ajrore ?

Likidi i mushkërive fetale është sekretuar nga epiteli i rrugëve të frymëmarrjes si një filtrat i lëngut intersticial të mushkërive nga transporti aktiv i kloridit.²⁴

Rrjedhimisht përmbajtja e klorurit të likidit të mushkërive fetale është e lartë dhe përmbajtja e proteinave është shumë e ulët. Shkalla e prodhimit është e lartë, ndonëse matjet e drejtpërdrejta nuk janë të disponueshme për fetusin e njeriut. Vëllimi i likidit të mushkërive fetale të deleve rritet nga mesi I shtatzënise dhe niveli i sekretimit rritet deri në rreth 4ml / kg / orë në fazën e vonshme të shtatzënisë²⁵.

Prodhimi dhe mirëmbajtja e vëllimit normal të likidit të mushkërive fetale është thelbësor për rritjen normale të mushkërive. Shkalla elektrokimike për prodhimin e likidit të mushkërive të fetusit është e rëndësishme dhe mund të mbidistendojë hapësirat ajrore.

Një përlllogaritje hipotetike mund të ndihmojë mjekun të kuptojë pse lëngu i mushkërive mund të kompromentojë adaptimin e te porsalindurit.

Nese nje femije ne term me peshe 3 kg ka afersisht 30 ml/kg te likidit fetal ne hapesirat ajrore ne lindje me sectio caesarea pa aktivitet lindjeje dhe qe intubohet , pengon drenimin pasiv te likidit nga mushkerite. Duke ditur qe volumi I gjakut tek ky femije eshte 80 ml/kg dhe hematokriti eshte 50% atehere volumi I plazmes eshte 40ml/kg. Likidi pulmonar I fetusit do te lëvizë nga hapësira ajrore në intersticiumin pulmonar duke ndërhyrë kështu fillimisht në mekanizmat pulmonar dhe shkëmbimin e gazeve. Ky likid do të transferohet në plazëm, duke rritur kështu volumin e plazmës nga 40 ml/kg në 70 ml/kg. Ky transferim ndodh me orë të tëra në realitet. Megjithatë, volumi i likidit në pulmonin e fetusit që duhet të akomodohet gjatë adaptimit neonatal rrit stresin për të porsalindurin.

2.2.2 Frymëmarrja në lindje

Komponenti më i rëndësishëm gjatë peridhës së adaptimit të te porsalindurit në lindje është ruajtja e përpjekjeve adekuate respiratore. Stimujt që ndryshojnë modelin e frymëmarrjes fetale në mënyrë të menjehershme mbeten të paperfunduara sic janë edhe stimujt tjerë të adaptimit në lindje.

Pjesën më të madhe të informacionit për frymëmarrjen fetale dhe tranzicionin pas lindjes e kemi nga studime të vjetra që përdorin modele të deleve me disa verifikime në fetusin njëzëror.²⁶ Statusi fetal in-utero klasifikohet në gjumë REM dhe gjumë të qete pa periudha të qarta zgjimi. Gjate gjumit REM fetusit ka aktivitet frymëmarrjeje të parregullt që karakterizohet me kohe të gjata inspiratore e ekspiratore si dhe me variabilitet të volumit të likidit pulmonar fetal (I perzier me likidit amniotic) brenda e jashtë pulmonit.

Frymëmarrja fetale , gëlltitja si dhe aktiviteti I levizjes janë të kufizuara gjatë gjumit REM , me levizje minimale gjatë gjumit të qete. Hipoksia fetale dobëson frymëmarrjen fetale ndërkohë që vlera të larta të PO₂ fetal stimulojnë frymëmarrjen fetale. Me lindjen fetuset e deleve nuk e fillojnë

frymemarrjen derisa kordoni te kapet. Ky observim ka ngritur hipotezen qe frymemarrja suprimohet nga nje substance placentare pervec se ne stadin REM . Fetusi I deles po ti jepet infusion me prostaglandin E₂ ndalon frymemarrjen , ndersa trajtimi me inhibitoret e sintezes se prostaglandinave si indomethacin shkakton vazhdim te frymemarrjeve fetale ²⁷.

Efekti I paster i fetusit normal ne periudhen e tranzicionit eshte fillimi I shpejte I frymemarrjes te fuqishme si rezultat I kombinimit te stimujve nga kapja e kordonit (dhe largimi probable e prostaglandinave qe suprimojne frymemarrjen) , stimujt taktil difuz dhe te ftohes qe veprojne ne menyre centrale ne ndryshimin e niveleve te PCO₂ dhe PO₂ ne gjak. I porsalinduri nuk do te filloje frymemarrjen ne rastet e hipoksise se thelle.

Veçanërisht, në mungesë të hipoksise, pothuajse të gjitha bebet ne term do të fillojnë efektivisht frymëmarrjen. Shumica e foshnjave preterm gjithashtu do të fillojnë me sukses frymëmarrjen nëse u jepet mundësia ²⁸.

2.2.3 .Surfaktanti dhe adaptimi pulmonar

Zhvillimi adekuat i mushkërive fetale për të mbështetur shkëmbimin e gazeve është adaptimi thelbësor në përgatitjen për lindje. Gjatë tremestrit të fundit të shtatëzanisë, mushkëria fetale zbërthehet në rreth 4 milionë saccule distale (bronkiole respiratore dhe kanalet alveolare) që rrjedhin nga 17 brezat e rrugëve të frymëmarrjes për rreth 32 javë dhe pastaj ndahet më tej në formimin e alveolit .²⁹

Paralelisht, masa e indeve parenkimale të mushkërive zvogëlohet në krahasim me peshën e trupit keshtu që vëllimi i gazeve i rrugëve të frymëmarrjes dhe alveolave rritet në menyre te dukshme.

Në të njëjtën kohë, nga rreth 22 javë të moshës gestacionale lipidi i surfaktantit dhe proteinat lipofilike SP-B dhe SP-C fillojnë të sintetizohen dhe agregohen në trupa lamellarë në qelizat e pjekur të tipit II .³⁰

Trupat lamellare janë vendet e depozitimit dhe sekretimit për komponentët esenciale biofizike të surfaktantit. Ndërsa mushkëria maturohet , gjithnjë e më shumë trupa lamellarë lëshohen në lëngun e mushkërive fetale dhe më pas përzihen me lëngun amniotik ose gëlltiten. Në afersi te kohes ne term te shtatëzanise qelizat e llojit II në mushkërite fetale përmbajnë shumë më tepër surfaktant se sa mushkërite e te rriturit , dhe kjo “pishinë e madhe” me surfaktant është gati për lirim para dhe gjate lindjes.

Me afrimin e lindjes, sekretimi i lëngjeve të mushkërise fetale bie (shih më lart) dhe vëllimi i lëngjeve të mushkërise fetale mund të ulet. Njëkohësisht, surfaktanti është sekretuar në lëngun e mushkërise fetale gjate lindjes , gjë që do të rrisë perqendrimin e surfaktantit në likidin e mushkërise fetale ³¹.

Mediatorët e supozuar të këtij sekretimi janë rritjet e katekolaminave që stimulojnë Beta-receptorët. Agonistët Purinergic si ATP gjithashtu mund të promovojnë këtë sekretim para lindjes. Ne vazhdimësi fillimi i ventilimit qe ndodh pas lindjes shkakton shtrirje alveolare dhe gjithashtu deformim te qelizave të tipit II, një sinjal tjetër sekretimi.

Rritja e larte e katekolaminave qe ndodh pas lindjes mund te stimulojë më tej sekretimin e surfaktantit . Në kafshët ne term menjëherë pas lindjes , madhësia e pishinës alveolare të surfaktantit është rreth 100 mg / kg. Kjo vlerë është 5 deri në 20 herë më e lartë sesa vlera e surfaktantit në alveolat të kafshëve të rritura të shëndoshë apo të njerëzve. Edhe pse nuk ka asnjë matje për njeriun ne term , një vlerë e tille e sasise se surfaktantit ka të ngjarë te jete e pranishme

në lëngun amniotik në term. Kështu fetusit në term e ka të siguruar sasinë e duhur të surfaktantit për periudhën e tranzicionit të frymëmarrjes në ajër³².

Vlerat e larta të surfaktantit bien në nivelet e të rriturve gjatë javës së parë të jetës në modelet e kafshëve.

3. SEMUNDSHMERIA RESPIRATORE NEONATALE NE SCE

Shumë studime kanë treguar një incidencë të lartë si të sëmundshmërisë respiratore dhe të pranimit në terapi intensive të bebeve të lindura me Sectio Caesarea pa aktivitet lindjeje .

Nga ana tjetër, incidenca e asfiksise ne lindje, e traumave dhe aspirimit mekonial janë më të ulta: 33-58 5.7,20,27,28,30,33,34,35,43,44,47-52,60,65 -68,70,72.

Për bebet e lindura në term apo afër termit është e vështirë të mblidhen të dhëna të sakta për shpeshësinë e insuficenses respiratore dhe të rezultateve afatgjata të saj, për shkak të mungesës së databasave të mëdha, të cilat zakonisht janë të disponueshme për bebet premature; megjithatë është raportuar që një numër i konsiderueshem i bebeve në term të lindura me SCE janë pranuar në Reanimacionin Neonatal cdo vit ne U.S,⁵⁹ me diagnozën e takipnese tranzitore neonatale (TTN)^{37,39,41,45,48,52,58,60-64} e detresit respirator (DR)^{37,39,45,48,58,61,65,66}, të hipertensionit pulmonar të te porsalindurit (HP) dhe /ose insuficencës respiratore hipoksike^{46-48,56}

3.1 Përse sectio caesarea elektive paraqet një rrezik të lartë për neonatin ?

Duke qenë se SCE zakonisht kryhet ndërmjet javeve 37 dhe 40 të shtatzanisë mendohet që sëmundshmëria respiratore e bebes është e lidhur me prematuritetin jatrogjenik.⁶³

Shume studime kanë treguar që sëmundshmëria respiratore në SCE është në përpjestim të zhdrejtë me moshën e shtatzanisë kur është kryer SCE^{40,46,53}.

Keshtu Hansen dhe bashkepuntorët në një studim kohortë e prospektiv tek bebet e lindura ndërmjet 37-41 jave shtatzanie gjeten që shpeshësia e sëmundshmërisë respiratore dhe e rasteve të rënda është e lartë të bebet e lindura me SCE në moshë shtatzanieve 37, 38 dhe 39 javë.⁴⁶

Për të pakesuar shfaqjen e DR pati rekomandime që në SCE të bëhej testi i maturitetit të mushkerive fetale; por ky test nuk pati popullaritet për shkak të rreziqeve të lidhura me amniocentezën. Për më tepër testi i likidit amniotik për maturimin e mushkerive fetale nuk e përjashton riskun e Detresit respirator, duke qenë se, deficiti i surfaktantit nuk është shkaku i vetëm. Ndryshimet në vaskularizimin e mushkërive, të tilla si ngadalësimi i shumezimit të qelizave të muskujve të lëmuar në lindje, rritja e enëve të vogla të gjakut (deri në 40 herë) në tremujorin e tretë dhe, ndryshimet në kanalet epiteliale të natriumit në drejtim të shtimit të aftësisë për të pastruar likidin nga mushkëritë fetale në term dhe me aktivitet lindjeje; të gjitha këto luajnë një rol të rëndësishëm. Shtyrja e kohës së kryerjes së SCE nga 38 në 40 jave shtatzanie ka treguar një rënie të rrezikut të detresit respirator por ekziston rreziku për një lindje spontane apo feto morto⁶⁷.

Për më tepër, foshnjat e lindura nepermjet SCE janë në rrezik më të lartë për zhvillimin e takipnese tranzitore të të porsalindurit,(sindromi i mushkërisë të lagur) dhe hipertensionit pulmonar. Megjithatë shqetësimi i frymëmarrjes zakonisht konsiderohet i përkohshëm me rimëkëmbjen e plotë pa ndonjë pasojë afatgjatë, një numër i konsiderueshem i bebeve me takipne respiratore zhvillojnë një insuficencë të rëndë në frymëmarrje.⁶⁸ Këta të porsalindur jo vetëm që kërkojnë hospitalizim të zgjatur, por gjithashtu paraqesin rrezik të rritur për sëmundje kronike të mushkërive dhe vdekje⁶⁸.

Po ashtu keto bebe kane një incidencë më të lartë të depresionit të frymëmarrjes në lindje (rezultatet e ulëta Apgar) ⁶¹ që mendohet të jete e lidhur me praninë e likidit në mushkeri; duke e bere periudhen tranzitore te kalimit në frymëmarrjen në ajër më të vështirë.

Në përpjekje për të zvogëluar prematuritetin iatrogjenik të pulmonit lidhur me lindjet me SCE rekomandohet planifikimi i SCE në 39 javë ose më vonë në bazë të dates se menseve te fundit, ose duke pritur për fillimin e aktivitetit spontan (Guidelines for Perinatal Care, 5th edition, p 148).

3.2. Roli i likidit te mbetur në mushkëritë e fetusit në sëmundshmerine neonatale respiratore dhe si pastrohet likidi fetal nga mushkëria e bebit

Fetusi në lindje përballet me nje sfidë te rendesishme ⁶⁹. Atij i kerkohet qe per nje periudhe shume te shkurter të pastrojë hapësirat e ajrit nga lëngjet që ai ka sekretuar gjatë shtatzënisë. Aftësia e një fëmije për të vetë-ringjallur veten në lindje, pasi ka qene "i zhytur" në lëngje për pjesën më të madhe të jetës së saj është me të vërtetë e mrekullueshme, duke patur parasysh se viktimat e mbytyjes ne uje me sasi të ngjashme të lëngjeve në mushkëri perpiqen shume me pak se kaq. ^{69,70,71} Epiteli i mushkërive është një lojtar kyç në këtë proces, i nevojshem per te bere kalimin nga kembimi i gazeve ne placentë ne ate ne ajër. ^{70,72-79}

Per nje shkëmbimin efektiv të gazit, hapësirat alveolare duhet të pastrohen nga lëngjet e tepërta dhe rrjedha e gjakut pulmonar të rritet për të përshtatur ventilimin me perfuzionin. Dështimi i njëjës prej këtyre ngjarjeve mund të rrezikojë tranzicionin neonatal dhe të shkaktojë që foshnja të shfaqe detres respirator. Në kohët e sotme ende nuk është i qarte mekanizmi (mekanizmat) me të cilat mushkëritë e fetusit janë në gjendje të pastrohen nga lëngjet e tepërta gjatë lindjes. ²⁵

Shpjegimi tradicional qe bazohet ne "forcat e Starlingut" dhe "shtrydhjen vaginale" ka vlerë vetëm për absorbimin i një pjese të vogël te likideve. ⁸⁰⁻⁸⁴

Transporti i Na (*Amilorid-sensitiv*) nga epiteli i pulmoneve ndermjet kanaleve epiteliale te Na (ENaC) mendohet te jetë celësi i lëvizjes transepiteliale te likidit alveolar ^{71,73,74,77,78,85-89}

Dëmtimi i këtij procesi con në shfaqjen e disa semundjeve si takipnea transitore neonatale ⁹⁰ dhe semundje te membranave hialine. ⁹¹ (Fig. 1)

Heqja e likidit te pulmonit qe ka filluar perpara lindjes, vazhdon pas *lindjes me heqjen e likidit nëpërmjet disa rrugëve te mundshme si; nyjeve limfatike pulmonare* ⁷⁶ *eneve te gjakut* ⁹² *rrugeve te sipërme te frymemarrjes, mediastinumit, dhe hapesires pleurale* ⁹³.

Ka evidenca te koheve te fundit qe tregojne se largimi i likidit nga pulmoni lehtesohet nga funksioni ciliar ⁹⁴ dhe, per kete femijet ne term me defekt gjenetik te struktures apo funksionit te cilieve kane nje prevalence te larte të semundshmerise respiratore neonatale. ⁹⁴

Tashme eshte e qarte qe transporti aktiv i Na permes epteliumit pulmonar con likidin nga hapesirat pulmonare ne intersticium, me absorbim te metejshem nga vaskularizimi. ^{25,69}

Ne pulmone, reabsorbimi i Na eshte nje proces 2 hapash ⁹⁵. Hapi i pare eshte levizja pasive e Na nga lumeni nepermembranes apikale ne qelize neper kanalet e joneve te pershkueshme te Na. Hapi i dyte eshte dalja aktive e Na nga qeliza permes membranës basolaterale në hapesirën seroze. Studimet në neonatët kanë treguar që imaturiteti në mekanizmat e transportit te Na ndikon ne shfaqjen TTN apo DR. ^{90,91}

Gowen dhe bashkepuntorë qenë të parët që treguan te neonatet me TTN nje imaturitet te transportit te epteliumit pulmonar, duke matur nje diference te shprehur midis epteliumit nasal

dhe hapësirës subkutane të “pikës së rënies nga amiloridi (*amiloride-induced drop*)”. Kjo diferencë është e ulur në femijet me TTN dhe sugjeron një defekt në transportin e Na, nderkohe që permisimi i TTN në 1 deri 3 dite lidhet me një rritje të diferencës në nivele normale⁹¹

Diversiteti I Kanaleve Epiteliale të Na: Miksimit e Përputhjes e Subuniteteve




Figura 2. Skema që përmbledh funksionin e kanaleve të Na amiloride-sensitivë në mushkëri. Ambienti i alveolave, tensioni i O₂, ekspozimi ndaj steroideve dhe distendimi alveolar mund të influencojnë subunitetet e ENaC. Linjat e transmetimit të sinjaleve të ndërmjetësuar nga disa proteine kinaza duke përfshirë A, G dhe C rregullojnë secilën prej këtyre llojeve të kanaleve në mënyra të ndryshme. T1 dhe T2 qelizat me lloje të ndryshme të kanaleve (dhe, rrjedhimisht, rregullime të ndryshme) do të kenë nivele shumë të ndryshme të transportit të natriumit që do t'i përgjigjen krejt ndryshe agjentëve hormonalë dhe transmetues.

Ndryshimet zhvillimore në jonet transepiteliale dhe levizja e likideve në pulmone mendohet se kalojnë në 3 stadi. Në stadin e parë epiteliimi pulmonar qëndron në fazën ekskretore, që bazohet në sekretimin e klorideve ndërmjet kanaleve të Cl⁻, dhe një aktiviteti absorbues të ulët të kanaleve të Na. Stadi i dytë përfshin një ndryshim në drejtimin e levizjeve të joneve dhe të ujit. Kemi jo vetëm një rritje të pranishmë të kanaleve të Na në epiteliimin e pulmonit, por gjithashtu edhe një vendosje në punë të kanaleve selektive të Na, gjë që mund të çojë në ndryshim të barrierës potenciale të membranës, me pasoje ndryshimin e drejtimit të Cl⁻ neper kanalet chloride.

Stadi i fundit paraqet epiteliumin pulmonar me një predominim të absorbimit të Na ndërmjet kanaleve të sodiumit dhe reabsorbim të mundshëm të Cl, me një balance fine midis aktivitetit të kanaleve të joneve dhe membranës ndërlidhese. Kjo bën të mundur një lagështi optimale të sipërfaqes së alveolave ndërkohe që parandalon grumbullimin e tepërt të likidit.²⁵

3.3 Vlerësimi i një të porsalinduri me probleme respiratore

Nuk është për t'u habitur që tranzicioni jo i plotë kardipulmonar rezulton në problem të frymëmarrjes me rreth 10% të të porsalindurve që kërkojnë support respirator menjëherë pas lindjes dhe deri në 1% që kërkojnë reanimim intensiv⁹⁶.

Prandaj Shoqata Amerikane e Zembrës dhe Akademia Amerikane e Pediatriës rekomandojnë që personeli që merr pjesë në porsalindurin në dhomën e lindjes duhet të jetë I certifikuar nga Programi I reanimimit neonator (NRP).⁹⁶ Shkaku i problemeve respiratore mund të jetë me origjinë pulmonare ose jopulmonar.

Qasja fillestare në vlerësimin i një të porsalinduri me probleme respiratore përfshin ekzaminimin fizik dhe vlerësimin e shpejtë për të identifikuar sëmundje vdekjeprurëse si p.sh. pneumothorax valvular, chylothorax, hernie diaframatike kongjenitale ose anomali të rrugëve të sipërme të frymëmarrjes. I porsalinduri me probleme respiratore sinjifikative dhe hipoksi fillimisht duhet të stabilizohen.

Kur ndjek një shtatzani me rrezik të lartë, historia antenatale e oligohydramnios sugjeron mushkëri hipoplastike, ndërsa polyhydramnios mund të jetë e pranishme tek foshnjat me fistula tracheoesophageale (TEF).

Foshnjat e nënave diabetike janë në rrezik për DR, takipnea tranzitore neonatale (TTN), ose anomalitë kardiake që shkaktojnë probleme të frymëmarrjes; fetusit me vështirësi respiratore me likidin amniotik të ngjyrosur është në rrezik për të shfaqur pneumonia nga aspiracioni mekonial, pneumotoraks dhe hipertensioni pulmonar (Tabelë 2).

Historia e chorioamnionitis mund të jete çelësi i pneumonise apo sepsisit prezent tek neonati. Përsëritja e ekzaminimit fizik pas stabilizimit fillestar për paqëndrueshmërinë e temperaturës me përkeqësimin e statusit klinik sugjeron infeksion; takikardi mund të tregojë sepsis ose hypovolemia. Stridori zakonisht shoqëron obstrukcionin e rrugëve të sipërme respiratore.

Një bark skafoid me degjim të zorreve në pjesën e majtë të krahërorit sugjeron hernie diaphragmale kongjenitale. Frymëmarrje asimetrike sugjeron për pneumotoraks valvular apo vendosja jo në vendin e duhur të tubit endotrakeal.

Këto fëmijë duhet të observohen nga afër për të siguruar që këto shenja nuk janë tregues të sëmundjes themelore. Ndërhyrjet në kohë, të cilat mbështesin stabilitetin termik, nivelet e duhura të glukozës në gjak dhe oksigjenim adekuat, do të parandalojnë foshnjat me një tranzicion të komplikuar nga përjetimi i sëmundshmërisë ose vdekshmërisë së panevojshme.⁹⁷

Shenja të sëmundshmërisë respiratore përfshin rënkimet respiratore flegra, tërheqje dhe takipne. Neonatët që paraqiten me këto shenja kërkojnë një ekzaminim të kujdeshëm duke përfshirë dhe një anamnezë të kujdeshme antepartum dhe ate intrapartum.

Tabela 2. Semundshmeria Respiratore Neonatale

Identifikon problemet më të zakonshme të frymëmarrjes në të porsalindurin. Prania e faktorëve të rrezikut për sepsis ose sëmundje primare të frymëmarrjes sugjeron nevojën për ndërhyrje më të hershme dhe më agresive sesa mund të garantohet për një fëmijë pa faktorë rreziku.

| Semundjet | Patologjia | Faktoret e rrezikut |
|---|--|---|
| <i>Takipnea Tranzitore Neonatale (TTN)</i> | Moseleminim i likidit fetal pulmonar | Preterm I vonshem Lindja me S.C. sidomos pa aktivitet lindjeje Femije I nenes diabetike |
| <i>Detresi respirator (RDS)</i> | Deficiti i surfaktantit Imaturitet anatomik | Prematuriteti |
| <i>Aspiracion mekonial</i> | Pneumonitis kimik sekondar nga inaktivizimi i surfaktantit nga mekoniumi. | Term ose postterm Prezenca e mekoniumit ne likidin amniotik |
| <i>Pneumonia</i> | Fillimi i kaskades inflamatore Deficit sekondar i surfaktantit Semundshmeri sistemike | Preterm PROM Kolonizimi maternal me streptokok i grupit B Infeksion maternal i traktit urinar apo patologji febrile |
| <i>Hipertensioni Pulmonar Neonatal (PPHN)</i> | Pamundesi e rezistences vaskulare pulmonare per tu ulur pas lindjes, Shunti djathtas –majtas prezent Hipoksemi e rende dhe acidoze | Preterm I vonshem/Term Histori e aspirimit mekonial sepsis, RDS, hernia diafragmale Semundje kongenitale kardiake |

3.4 Problemet me ndryshimet në aparatën respirator dhe në qarkullimin tranzitor

Ka arsye të ndryshme pse të porsalindurit nuk mund të përshtaten normalisht me jetën ekstra-uterine për shkak të situatave hypoxike para apo gjatë lindjes. Siç shihet, kompromentimi për shkak të hypoxisë mund të shkaktohet nga faza e dytë e zgjatur e lindjes, infeksioni perinatal, komprimimi i kordonit umbelikal, humbje të konsiderueshme gjaku intrapartum, keqprezantimi çojnë në lindje të zgjatur e të vështirë, shtatzani post term. Hypoxia do të çojë mëtej në vazokonstriksion të enëve pulmonare dhe mund të mbaje të hapur duktusin arteriosus.

Rezistenca në enët pulmonare mund të beje që presionet në zemër të mbeten të njëjta si janë në jetën uterine dhe kështu foramen ovale do të qëndroje e hapur dhe gjaku do të shuntohet nga e djathta në të majtë nëpërmjet saj. Meqë placenta nuk funksionon më, fëmija do të mbetet hipoksik. Kjo është një karakteristike e sëmundjes e njohur si hipertension pulmonar persistent i të porsalindurit. (PPHN)

Shikoni prapa në figurën 1 dhe shqyrtoni implikimet e kësaj situate tek një neonat që nuk mbështetet më në placentën e vet për këmbimin e gazeve. Kjo fotografi është e plotësisht normale in utero ku presioni parcial i O₂ i fetusit është shumë më i ulët krahasuar për vlerat neonatale si rezultat i shuntit djathtas-majtas dhe përzierjen e gjakut të paoksigjenuar me atë të oksigjenuar që shpërndahet në trup. Kjo sigurisht që nuk është normale në jetën neonatale dhe kështu, nëse qarkullimi i fetusit vazhdon pas lindjes, do të kemi praninë e hipoksisë. Trajtimi për PPHN përfshin përpjekjen për të ulur rezistencën pulmonare vasculare, ndalimin e shuntit majtas djathtas dhe të nxise oksigjenimin.

3.4.1 Takipnea Tranzitore Neonatale

Kjo sëmundje shfaqet tek neonati afër termit, në term apo tek prematurët e “vone”, duke prekur 3.6 deri në 5.7 për 1000 neonat në term dhe mbi 10 për 1000 neonat preterm. Faktorët e rrezikut përfshijnë lindjen caesareane, mund të ndodhin në nënat me diabet, astmë, aktivitet lindjeje të zgjatur, apo vuajtja fetale që kërkon anestezi ose analgjezia.

Prezantimi klinik është një frymëmarrje siperfaqësore e shpejtë e shoqëruar me rënkitime të rralle me insuficencë respiratore.^{39,98,99}

Në analizen e ekuilibrit acido-bazik vërejmë shkallë të ndryshme të hypoxemia shoqëruar me normocarbiamë ose hypercarbiamë. Radiografia e pulmonit tregon theksim i vizatimit perihilar, infiltrate të dendura, theksim të vizatimit intersticial, likid në fisurat interlobare. (Figura 3).

Mund të jetë e vështirë të diferencohen TTN nga pneumonia neonatale ose aspiracioni mekonial në praninë të faktorëve të rrezikut për këto çrregullime. Mund të ketë një hije likid të lirë rreth zemrës, si dhe shenja të edemës alveolare.¹⁰⁰ Trajtimi i TTN është suportiv.^{39,98,99} Megjithatë, një diagnozë definitive e TTN zakonisht bëhet në retrospektivë sapo simptomat të zgjidhen brenda 1 deri në 5 ditë pas ndërhyrjes minimale terapeutike. Prandaj, duhet kohë për të dalluar TTN nga shkaqet e tjera të sëmundshmerisë respiratore neonatale. Deri në atë kohë trajtimi i përgjithshëm i të porsalindurit me sëmundje respiratore duhet të mbulojë të gjitha mundësitë diagnostike.

Kjo sëmundje zakonisht i përgjigjet mjaft mire oksigjeno-terapisë, por mbajtja e saturimit të oksigjenit në vlerat e duhura mund të kërkojë presion të vazhdueshëm pozitiv të rrugëve të likidit pulmonar shtesë. Shumë rrallë është e nevojshme ventilimi mekanik.¹⁰¹




Figura 3. Radiografia pulmonare e neonatit me takipnea tranzitore neonatale; Shihen zona hipodense dhe likid në fisurat horizontale (shigjetë).

Megjithëse TTN është një nga diagnozat më të zakonshme tek neonatët që paraqesin problematike respiratore nga eliminimi i vonuar i likidit pulmonar fetal, këto të sapolindur pothuajse gjithmonë shrohen plotësisht pa pasoja afatgjata.⁹⁹

Diagnoza diferenciale përfshin pneumoni dhe hiperventilim cerebral në pacientë me asfiksi perinatale. Neonatet janë takipneik pa ndryshime në radiografine pulmonare përveç një kardiomegalie të lehtë nga asfiksia.

3.4.2 Detresi Respirator

DR shfaqet shumë shpejt pas lindjes dhe përkeqësohet gjatë orëve në vazhdim.

DR zakonisht verëhet tek neonati preterm dhe ndodh për shkak të mungesës së surfaktantit. Rreziku i shfaqjes së DR rritet me uljen e moshës së gestacionale, preken rreth 5% të neonatit afër term, 30% të neonatit me moshë gestacionale nën 30 javësh si dhe 60% i neonatit preterm më pak se 28 javësh.^{102,103,104}

Surfaktanti është një përzierje komplekse e 6 fosfolipideve dhe 4 apoproteinave të prodhuara nga pneumocitet e tipit II në epitelin e mushkërive. Funkcionalisht, lecithina (fosfocolin dipalmitoil) është fosfolipidi kryesor, i cili së bashku me proteina surfaktante A dhe B ul tensionin në sipërfaqen ajër-leng in vivo.^{102,103,104}

Me zvogëlimin e sasisë së surfaktantit ose funksionit të tij, rritet tensioni në sipërfaqen alveolare dhe kolabohet në fund të ekspirimit. Sëmundja përparon me shpejtësi me rritjen e punës së frymëmarrjes, shuntin intrapulmonar, mospërputhjen V/Q dhe hipoksi me insuficience respiratore eventuale. Faktorët duke kontribuar në DR janë seksi meshkuj kaukazianë, foshnje të nënave me

diabet, asfiksionë perinatale, hipotermi dhe shtatzanite multiple, të lindura nëpërmjet lindjes caesareane pa aktivitet lindjeje, apo praninë e DR në një vëlla të mëparshëm.

Në ekzaminimin fizik, foshnjat kanë renkime, tërheqje, cianoze, dhe takipnea. Radiografia pulmonare tregon pamjen retikulogranulare, bronkogramin e ajrit, ose pamjen e qelqit të mushkërive për shkak të mikroatelektasisë dhe zgjerimit të dobët (Fig. 4).

Në ekuilibrin acido-bazik vërehet acidozë respiratore, hipoksi, dhe acidozë metabolike. Nënmat me foshnje preterm të thella duhet të menaxhohen në një qendër perinatale. Duhet të kryhet amniocenteza për të vlerësuar maturinë e mushkërive për lindjen me zgjedhje cesare dhe në nënat me diabet. Menaxhimi përfshin kortikosteroidet antenatale për të ndihmuar në maturimin pulmonar të fetusit, përdorimin e agjentëve tokolitike për të parandaluar lindjen e parakohshme si dhe përdorimin e antibiotikëve për chorioamnionitis.¹⁰⁵

Foshnjat që kanë tërheqje të mesme respiratore dhe kërkojnë vlera FiO_2 më pak se 40% mund të vendosen në CPAP hundës prej 6 deri 7 cm H₂O. Nëse foshnja ka vështirësi në frymëmarrje me të rende, sigurohet ventilim i asistuar. Vlerat FiO_2 janë rregulluar për të mbajtur pH 7.25 dhe 7.40, vlera PaO_2 midis 50 dhe 70 torr, vlera PCO_2 në 45 deri në 65 torr, dhe deficieti bazë më pak se 10.¹⁰²⁻¹⁰⁷




Figura 4. Rografi pulmonare e të porsalindurit me Detres Respirator. Vërehen rrjeta retikulo-granulare në fushën pulmonare, mbiajrim dhe ulje të vëllimit pulmonar.

Studime që krahasojnë përdorimin e llojeve të ndryshme të preparateve surfaktante, kohën e administrimit dhe modalitetet e ndryshme të ventilimit janë diskutuar në disa botime.^{102,104,105,107}

Terapia mbështetëse përfshin mbajtjen e bilancit të lëngjeve dhe elektroliteve dhe shmangies së hipoglicemisë dhe hipotermisë.^{102,103,104,106} Hemokultura merret së bashku me qelizat e bardha të gjakut dhe numërimin diferencial bashkë me vlerësimin e proteinave C-reaktive. Antibiotikët (ampicilin dhe gentamicin ose amikacin) administrohen dhe tërhiqen pas 48 orësh nëse foshnja është e qëndrueshme. Ushqyerja enterale duhet filluar sa më shpejt që të jetë e mundur, preferohet përdorimi i qumështit të nënës. Gazrat e gjakut dhe radiografitë e gjoksit përsëriten si të treguara

klinikisht. Njësia e kujdesit intensiv neonatale (NICU) stafi duhet të inkurajojë lidhjen e nënës dhe foshnjave dhe mbështetjen e familjareve .

Komplikacione të vërejtura herët në dekursin e DR janë rrjedhjet e ajrit, apnea, hemoragji intraventrikulare, anemi, hipoglicemia, hypernatremia, ductus arteriosus , enterokoliti nekrotizues , si dhe dështimi i veshkave dhe rritjes ^{103,108,109}

Rezultati është përmirësuar duke shmangur komplikimet. Komplikimet e vonuara përfshijnë refluksin gastroezofageal, tolerancën jo të duhur të ushqyerjes, dështimi në rritje , apnea, vdekja e papritur, BPD, si dhe deficitet zhvillimore dhe neurologjike duke përfshirë edhe handicap në shikueshmëri e dëgjueshmëri . ^{101,108}

3.4.3 Hipertensioni Persistent Pulmonar Neonatal

HPPN percaktohet si një dështim i adaptimit të qarkullimit pulmonar të gjakut gjatë apo menjëherë pas lindjes, duke rezultuar në një rezistencë vaskulare pulmonare të lartë e rrjedhimisht do të cojë në një ulje të qarkullimit pulmonar të gjakut dhe ky gjak i paoksigjenuar do të shuntohet në qarkullimin sistematik ndërmjet një shunti djathtas-majtas ndërmjet një foramen ovale të hapur apo një ductus arteriosus ¹¹⁰

Faktorët e mundshëm të rrezikut, janë prematuriteti , mosmaturimi , infeksioni , sindromi i aspirimit mekonial, anomalitë gjenetike dhe anomalitë strukturore.

HPPN është një sindromë komplekse klinike me një incidencë të vlerësuar prej 1.9 për 1000 lindje të gjalla (0.4-6.8 / 1000 lindje të gjalla) në Shtetet e Bashkuara dhe 0.43-6 për 1.000 lindje të gjalla në Mbretërinë e Bashkuar, dhe një shkallë të vdekshmërisë që varion nga 4-33%. ¹¹¹

3.4.3.1 Etiologjia dhe Fisiopatologjia e PPHN

Bazuar në etiologji ,HPPN mund të kategorizohet në 7 grupe të mëdha :

- Idiopatike-jo patologji pulmonare prezente dhe Qp është e ulur nga një rimodelim abnormal vaskular që çon në vasokonstriksion pulmonar.
- Tranzicion jo normal në lindje – asfiksia perinatale, DR, dhe takipnea tranzitore neonatë, (TTN) që rezultojnë në një vazodilatacion pulmonar të demtuar në lindje.
- Semundje parenkimale (e njohur si “HPPN sekondare”)—shkak i sindromit të aspiracionit mekonial dhe pneumonisë.
- Zhvillim jonormal i mushkerive-hipoplazia pulmonare nga oligohidroamnios sekondarë nga mosfunksionimi/anomalitë renale apo PROM, hernia diafragmale apo malformime të tjera pulmonare.
- Obstruksioni intravaskular shkak i hiperviskozitetit- policitemia
- Hipertensioni pulmonar në femijet preterm në fazën fillestare të RDS ¹¹²
- Hipertensioni venoz pulmonar ¹¹³

Ndërprerja e tranzicionit normal të qarkullimit neonatal për shkak të këtyre faktorëve rezultojnë në dështimin për të zgjidhur hipertensionin pulmonar të fetusit dhe çon në shfaqjen e PPHN.

Rezistenca vaskulare pulmonare e larte zvogëlon qarkullimin e gjakut në mushkëri, sepse gjaku merr rrugën e rezistencës më të vogël, e cila është ajo e qarkullimit sistemik.

Mospërputhja e ventilimit-perfuzionit dhe shuntimi ekstrapulmonar djathtas-majtas të gjakut të deoksigjenuar nëper foramen ovale apertum (PFO) dhe ductus arteriosus (PDA) do te coje ne shfaqjen e cianozës . Cianoza diferenciale (SatO₂ në gjymtyrët e poshtme është > 5% -10% më e ulët se gjymtyrët e sipërme e djathtë) ndodh për shkak të shuntimit nga arteria pulmonare në aortë përmes PDA. Nëse PDA është e mbyllur dhe shunti ndodh ekskluzivisht në nivelin PFO, shkalla e SatO₂ është e ngjashme në gjymtyrët e sipërme dhe të poshtme. Hipoksemia e paqendrueshme (ndryshimi i dukshem në SatO₂ me ndryshime minimale ose jo në parametrat e ventilatorit apo te fraksionit te oksigjenit te inspiruar [Fio₂]) është karakteristikë e PPHN dhe ndodh për shkak të ndryshimit në vëllimin e shuntit djathtas –majtas , nga balanca delikate midis rezistencës vaskulare pulmonare dhe asaj sitemike.

Disa kushte të rëndësishme klinikisht të lidhura me HPPN janë përshkruar më poshtë.

Takipnea tranzitore neonatale është shoqëruar me HPPN. Për shembull, pas lindjes me sectio cezarea elektive te porsalindurit me TTN që ka hypoxemia mund ti jepen përqendrime të larta të oksigjenit te inspiruar (afërsisht 100%) me Hood apo kanjula nasale (pa presione positive). Në këto raste, mund të zhvillohet atelektaze absorbuese , qe con në rritjen e kërkesave per oksigjen dhe insuficence respiratore (Fig 4). Për më tepër, formimi i specieve reaktive të oksigjenit nga oksigjeni i lartë alveolar mund të çojë në rritjen e rezistences vaskulare pulmonare, duke kontribuar edhe me teper në HPPN. ^{114,115}

Termi TTN malinje është përdorur për të përshkruar morbiditetin respirator te rëndë dhe vdekshmërinë e tek të porsalindurit te lindur me sectio caesarea elektive , të cilët kanë shfaqur PPHN ⁴⁸

Një strategji e mundshme për menaxhimin e këtyre të sapolindurve (dhe për të parandaluar TTN malinje) mund të jetë përdorimi i hershëm i presionit positive (si presioni i vazhdueshëm pozitiv i rrugëve të frymëmarrjes kur FiO₂ tejkalon 0.5-0.6) për të inflatuar e për të futur ne pune mushkëritë, versus perdorimit te koncentrimave te larta te O₂ pa presion pozitiv.




Figura 5. Etilogjia dhe Fispatologjia e HPP

3.4.3.2 Diagnoza

Tek një neonat hipoksik, është mjaft e rëndësishme diagnoza diferenciale ndërmjet sëmundjeve kardiace kongenitale cianogjene nga HPPN . Vlerësimi fillestar duhet të përfshijë një anamnezë të plotë dhe ekzaminim fizik, matje të njëkohshme të SatO₂ pre dhe postduktal, radiografinë e toraksit, dhe EAB. Hipoksemia disproporcionale me gravitetin e sëmundjes parenkimale në radiografinë e toraksit duhet të sugjerojë HPPN idiopatike (ose sëmundje kardiace cianogjene). SatO₂ preduktal dhe postduktal dhe matjet PaO₂ janë përdorur për të diferencuar HPN nga sëmundjet kardiace strukturore . Diferenca në SatO₂ me shumë se 5 % deri 10% apo ndryshimet PaO₂ prej 10 deri në 20 mm Hg midis ekstremiteteve të sipërme të djathta dhe atyre të poshtme konsiderohen të rëndësishme. Tek i porsalinduri me HPPN dhe shunt dhjathtas –majtas në nivelin atrial pa një shunt duktal sinjifikant, SatO₂ si në krahun edhe në këmbën e djathtë do të jenë të ulëta. Anasjelltas, foshnjat me PDA dhe coarctacion të aortës mund të kenë cianozë diferenciale . Në HPPN, hipoksemia është shpesh e paqëndrueshme ndryshe nga hipoxemia stabile që shihet në sëmundjen kongenitale cianogjene .

Ekokardiografia është standardi i artë për të konfirmuar diagnozën dhe për të monitoruar efikasitetin e ndërhyrjeve terapeutike specifike në HPPN.

Matja e drejtimit të shuntit duktal dhe foramen ovale , rrafshimi ose devijimi i majtë i septumit interventrikular dhe shpejtësia e regurgitimit trikuspidal në valën e vazhdueshme Doppler me matje të njëkohshme të presioneve të gjakut na jep një informacion të rëndësishëm të presioneve të anes

se djathtë dhe mekanizmave fiziologjike hemodinamike. Vlerësimi i funksionit të ventrikulit të djathtë dhe të majtë do të udhëheqë në zgjedhjen e vazodilatatorit të duhur pulmonar.

3.4.3.3 Trajtimi

Terapia suportive

Graviteti i HPPN mund të shkojë nga hypoxemia e lehtë me shqetësim minimal respirator deri në hypoxemia të rënde dhe instabilitet kardipulmonar që kërkon kujdesit intensive mbështetës. Neonati me HPPN kërkon kujdes suportiv, duke përfshirë temperaturën optimale dhe kujdes në drejtim të ushqyerjes, shmangien e stresit dhe trajtimin me analgjezik sipas nevojës. Paraliza duhet të shmanget nëse është e mundur sepse është shoqëruar me rritje të vdekshmërisë.¹¹⁶

Terapi shtesë në varësi të sëmundjes primare. (të tilla si antibiotikë për pneumoni ose sepsis)

Rastet e lehta të HPPN kërkojnë trajtim suportiv me O₂ terapi. Duhet një monitorim i kujdesshem në keto raste sepse mund të kemi një agravim të situatës respiratore duke kërkuar ventilim joinvasiv apo intubim e ventilim mekanik. Rekomandohet ruajtja e pH më shumë se 7.25, preferohet 7.30 deri 7.40, gjatë fazës akute të HPPN.

Në drejtim të ventilimit mekanik fillimisht përdoret presioni pozitiv në fund të ekspirimit (PEEP) apo presion mesatar për të ulur rezistencën vaskulare pulmonare. Në rastet më të rënda përdorimi i ventilimit me frekuencë të larta përmison inflamacionin pulmonar dhe zvogëlon dëmtimin pulmonar.¹¹⁷

Kombinimi i ventilimit me frekuencë të larta së bashku me inhalimin e iNO përmison dekursin e HPPN si në rastet me DR dhe pneumonia, por s'ka dobi në rastet HPPN idiopatike ose hernie diafragmale kongenitale.¹¹⁷

Oksigjeni është një vazodilatator pulmonar specifik dhe i fuqishëm, por mund të jetë i dëmshëm nëse përdoret me tepri. Rekomandohet ruajtja e SatO₂ preduktal në vlera me të ulta baraz me 90 e me nivelet e PaO₂ midis 55 dhe 80 mm Hg gjatë menaxhimit të foshnjave me HPPN.

Foshnjat me HPPN sekondare nga sëmundjet parenkimale pulmonare duhet të marrin një dozë surfaktanti të pasur me proteina surfaktante B, të tilla si laktik ose alfa porakton.

Pas vlerësimit pulmonar me ose pa terapinë me surfaktant trajtimi i mëtejshëm bazohet në statusin e O₂, presionin sistematik të gjakut dhe funksionin kardial e ventrikular në baze të ekografisë.

4. QELLIMI DHE OBJEKTIVAT E STUDIMIT

4.1. Qëllimi

Vleresimi i sëmundshmërisë respiratore neonatale në sectio caesarea elektive, krahasuar me te posalindurit te lindur per via natyralis; apo me sectio caesarea emergjente .

4.2. Objektivat

- Të vlerësohet shpeshësia e Takipnese transitore neonatale ne bebet e lindura me sectio caesarea elektive, krahasuar me lindjet per via natyralis; apo me sectio caesarea emergjente .
- Të vlerësohet shpeshësia e Detresit respirator në bebet e lindura me sectio caesarea elektive krahasuar me lindjet per via natyralis; apo me sectio caesarea emergjente .
- Të vlerësohet shpeshësia e Hipertensionit pulmonar (Sëmundshmërisë respiratore të rëndë) ne bebet e lindura me sectio caesarea elektive krahasuar me lindjet per via natyralis; apo me sectio caesarea emergjente .
- Të vlerësohet ndikimi i kohës së kryerjes të sectio caesarea elektive ne 37 + 0 jave deri ne 40 + 6 jave shtatzënie ne shpeshesine e Takipnese transitore neonatale .
- Të vlerësohet ndikimi i kohës të kryerjes te sectio caesarea elektive ne 37 + 0 jave deri ne 40 + 6 jave shtatzënie ne shpeshesine e Detresit respirator .
- Të vlerësohet ndikimi i kohës të kryerjes te sectio caesarea elektive ne 37 + 0 jave deri ne 40 + 6 jave shtatzënie ne shpeshesine e Hipertensionit pulmonar (Sëmundshmërisë respiratore të rëndë)
- Të vlerësohet raporti i gjasave të Takipnese transitore neonatale sipas mënyrën e lindjes.
- Të vlerësohet raporti i gjasave të Takipnese transitore neonatale tek bebet sipas kohëzgjatjes së shtatzënisë.
- Te vleresohet raporti i gjasave të Detresit respirator sipas mënyrën e lindjes.
- Te vleresohet raporti i gjasave të Detresit respirator tek bebet sipas kohëzgjatjes së shtatzënisë.
- Te vleresohet raporti i gjasave të Hipertensionit pulmonar sipas mënyrën e lindjes.
- Te vleresohet raporti i gjasave të Hipertensionit pulmonar tek bebet sipas kohëzgjatjes së shtatzënisë.
- Te vleresohet ndikimi i kohes se kryerjes te sectio caesarea elektive ne 37 + 0 jave deri ne 40 + 6 jave shtatzënie ne shpeshesine e pranimit ne Reanimacionin neonatal (NICU)
- Të vlerësohet Kohëzgjatja mesatare e qëndrimit në spital sipas mënyrës së lindjes.

-
- Të vlerësohen raportet e gjasave të sëmundshmërisë respiratore (TTN, detres respirator dhe HPP) tek bebet gjatë periudhës 2011-2016, sipas kohëzgjatjes së shtatzënisë dhe mënyrës së lindjes krahasuar me lindjen vaginale sipas javeve perkatese.
 - Të vlerësohet rezultatin mesatar të testit Apgar në minutën e parë dhe të pestë pas lindjes sipas mënyrës së lindjes.
 - Të vlerësohet proporcioni i bebeve që patën nevojë për reanimin dhe terapi me oksigjen në sallën e lindjes dhe në reanimacionin neonatal sipas mënyrës së lindjes.



5. MATERIALI DHE METODOLOGJIA

5.1 Subjektet e studiuara

Në këtë studim kohort retrospektiv u përfshinë 4290 bebet e lindura nga gratë shtatzena me sectio caesarea elektive ne moshe shtatzanie nga 37 0+6 ditesh deri 40 0+6 ditesh ne Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik 'Mbreteresha Geraldine ne periudhen 1 janar 2011 deri me 1 Janar 2017 pa zgjedhje, duke perjashtuar bebet e lindura me anomali kongenitale intrauterine, bebet nga shtatzanite me me shume se nje fetus (multiple) dhe bebet nga shtatzanite problematike si IUGR, diabet gestacional, preeklampsi.

Si grup kontrolli jane marrë ne menyre te rastesishme bebet e lindura ne menyre natyrale apo me sectio caesarea emergjente ne te njejten periudhe duke perjashtuar bebet e lindura me anomali kongenitale, bebet nga shtatzanite me me shume se nje fetus (multiple) dhe bebet nga shtatzanite problematike si IUGR , diabet gestacional, preeklampsi.

Bebet e lindura nga grate shtatzena ne grupet e mesiperme u ndane ne 4 grupe perkatese sipas moshes se shtatzanise :

bebet lindur ne moshe shtatzanie 37 +0- 6 jave

bebet lindur ne moshe shtatzanie 38 + 0-6 jave

bebet lindur ne moshe shtatzanie 39 +0-6 jave

bebet lindur ne moshe shtatzanie 40 + 0-6 jave

Variablat e studiuar :

Per Detresin respirator (DR)

- Prania e Cianozes
- Prania e Polipnese (FR > 60/min)
- Prania e Terheqje interkostale, epigastrike
- Prania e renkimeve ekspiratore
- Nevoja per O2- terapia me FiO2 \geq 40 % per te pakten 24 ore.
- Prania e Shenja radiologjike karakteristike (vizatim retikuloendotelial fin i parenkimes bronkopulmonare e mbiajrim pulmonar)

Per Takipnene transitore neonatale (TTN)

- Prania e Cianoze
- Prania e Polipnese (F.R >60/min)
- Prania e Renkimeve ekspiratore
- O2 terapi me FiO2 < 40%
- Dekurs klinik i lehte ne te moderuar qe zgjat nga disa ore deri 24-72 ore

-
- Ekz.radiologjik tipik (theksim i vizatimit bronkopulmonar ,mbiajrim bronkopulmonar)

Per Hipertensionin pulmonar (Semundshmeri respiratore te rende) (HP):

- Prania e cianozes se shprehur
- Takipnese (F.R.>60/min)
- Hipokseミア prezente ne FIO₂ 100%
- Kërkesa per trajtim me O₂ terapi per me shume se 3 dite
- Nevoja per N-IPPV apo ventilim mekanik ne cdo kohe

Të dhënat që u nevojiten për studim u nxorrën nga:

- *Kartela ditore e mjekut*
- *Kartela infermierore*
- *Përshkrimi i neonatologut për diagnozën*

5.2. Perpunimi statistikor

Për të analizuar, përshkruar, vlerësuar, krahasuar dhe interpretuar të dhënat e këtij studimi dhe lidhjet statistikore midis variableve të ndryshme të përfshira në të u përdorën një sërë treguesish, teknikash dhe testesh statistikore.

Per ndryshorët kategorikë u raportuan numrat absolutë dhe përqindjet përkatëse. Për ndryshorët numerikë (të vazhdueshëm apo diskretë) u raportuan madhësitë e prirjes qendrore (vlera mesatare) dhe madhësitë e dispersionit (deviacioni standard).

Për verifikimin e lidhjeve statistikore midis variableve të ndryshme dhe përcaktimin e domethënies statistikore të këtyre lidhjeve u përdorën teste statistikore në përshtatje me natyrën e variableve që marrin pjesë në lidhjet përkatëse.

Për vlerësimin e lidhjeve statistikore midis variableve kategorike u përdor testi statistikor hi katror. Ky test raporton vlerën e domethënies statistikore.

Për krahasimin e vlerës mesatare të variableve të vazhdueshëm të varur sipas kategorive të variablilit të pavarur u përdor testi t i studentit, për arsye të shpërndarjes normale të variableve në popullatën e studimit. Ky test raporton vlerën e domethënies statistikore.

U vlerësua trendi linear i semundshmerise respiratore sipas kohezgjatjes së shtatzenise dhe u gjykua lidhur me domethënies statistikore të trendit linear.

Për të përcaktuar lidhjen midis semundshmerise respiratore me variablet e pavarur, u përdor Regresioni Logjistik Binar. Ky test vlerëson raportin e gjasave (OR) të hasjes së parametrut të interesit sipas kategorive të variablilit të pavarur, duke marrë si referencë një prej kategorive të tij. U ndertuan dy modele të Regresionit Logjistik Binar. *Ne Modelin 1* u raportuan vlerat krudo (bruto) të raportit të gjasave (OR), të pakontrolluara apo axhustuara për asnjë faktor potencialisht konfondues. *Ne Modelin 2* të Regresionit Logjistik Binar lidhja u kontrollua (axhustua) për efektin potencial konfondues të moshës së nënës. Modeli 2 përfaqëson Modelin tone final, ku rezultatet

(OR) janë të kontrolluara për moshën e nënës. Regresioni Logjistik Binar raporton vlerën e domethënies statistikore dhe shkallën e lirise.

Për paraqitjen të dhënave u përdoren gjerësisht tabelat, të formatuara sipas llojit dhe natyrës së variabëlve në studim. Për paraqitjen vizuale të rezultatëve të studimit u përdoren grafike të llojeve të ndryshme, përfshirë bar-diagramet, diagramat vijë dhe në formë torte (pie-charts).

Në të gjitha rastet, u konsideruan si statistikiisht sinjifikante (të përfillshme) vlerat e $P < 0.05$. Të gjitha analizat u realizuan nepermjet programit statistikor *Statistical Package for Social Sciences (SPSS), versioni 19*.

6. REZULTATET dhe DISKUTIMET

6.1. REZULTATET

6.1.1 Të dhëna të përgjithshme për subjektet në studim


Në studim u përfshinë gjithsej 23414 bebe unike (jo lindje binjake, trinjake, etj.) të lindura nga gratë shtatzëna në ambjentet e Spitalit Unviersitar Obstetrik-Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” gjatë periudhës 2011-2016.

Mosha mesatare e grave në studim ishte 29.7 vjec \pm 6.2 vjet, duke variuar nga vlera minimale 16 vjec (e hasur në 16 nëna) deri në vlerën maksimale 49 vjec (e hasur në 4 nëna).

Shpërndarja e subjekteve në studim sipas viteve paraqitet në Tabelën 1 në vijim.

Tabelë 3. Numri i lindjeve gjatë periudhës 2011-2016

| Variabli | Numri i lindjeve | Përqindja |
|----------|------------------|-----------|
| Viti | | |
| 2011 | 3934 | 16.8 |
| 2012 | 4151 | 17.7 |
| 2013 | 3763 | 16.1 |
| 2014 | 4060 | 17.3 |
| 2015 | 3743 | 16.0 |
| 2016 | 3763 | 16.1 |
| Total | 23414 | 100.0 |




Grafiku 1. Shpërndarja e lindjeve unike sipas viteve, 2011-2016

Midis 23414 lindjeve unike gjatë periudhës 2011-2016, 17497 bebe ose 74.7% lindën në mënyrë normale, 1627 ose 7.0 % lindën me sectio caesarea emergjente dhe 4290 bebe ose 18.3% lindën me sectio caesarea elektive (Tabela 4).

Tabelë 4. Shpërndarja e bebeve të lindura sipas mënyrës së lindjes

| Variabli | Numri i lindjeve | Përqindja |
|------------------|------------------|-----------|
| Mënyra e lindjes | | |
| Lindje natyrale | 17497 | 74.7 |
| SC emergjente | 1627 | 7.0 |
| SC elektive | 4290 | 18.3 |
| Total | 23414 | 100.0 |



Grafiku2. Shpërndarja e lindjeve unike sipas mënyrës së lindjes, 2011-2016

Në Tabelën 5 paraqitet shpërndarja e bebeve të lindura gjatë periudhës 2011-2016, sipas mënyrës së lindjes dhe vitit të lindjes.

Tabelë 5. Shpërndarja e mënyrës së lindjes sipas viteve të studimit

| Variabli | Mënyra e lindjes | | | Total |
|----------|------------------|---------------|--------------|---------------|
| | Lindje natyrale | SC Emergjente | SC elektive | |
| Viti | | | | |
| 2011 | 2938 (16.8)* | 291 (17.9) | 705 (16.4) | 3934 (16.8) |
| 2012 | 3117 (17.8) | 308 (18.9) | 726 (16.9) | 4151 (17.7) |
| 2013 | 861 (16.4) | 248 (15.2) | 654 (15.2) | 3763 (16.1) |
| 2014 | 3085 (17.6) | 268 (16.5) | 707 (16.5) | 4060 (17.3) |
| 2015 | 2759 (15.8) | 241 (14.8) | 743 (17.3) | 3743 (16.0) |
| 2016 | 2737 (15.6) | 271 (16.7) | 75 (17.6) | 3763 (16.1) |
| Total | 17497 (100.0) | 1627 (100.0) | 4290 (100.0) | 23414 (100.0) |


* Numri absolut dhe përqindja sipas kolonave (në kllapa).

Tabela 6 paraqet shpërndarjen e mënyrës së lindjes grave në studim sipas radhës së lindjes aktuale. Dmth, nëse lindja apo sectio caesarea aktuale është lindja e 1-rë, 2-të, 3-të e kështu me radhë. Mund të vihet re që 43.1% e grave që lindën fëmijën në mënyrë natyrale e kishin këtë lindjen e parë, 54.8% e kishin lindjen e dytë ose tretë dhe 2.1% lindjen e katër. Ndërkohë, midis grave që lindën me sectio caesarea elektive 25.5% e tyre kishin lindjen e parë dhe 74.5% kishin lindjen e dytë ose tretë (Tabela 6).

Tabelë 6. Radha e lindjes aktuale sipas mënyrës së lindjes

| Variabli | Mënyra e lindjes | | | Total |
|-------------------------|------------------|---------------|-------------|--------------|
| | Lindje natyrale | SC Emergjente | SC elektive | |
| Radha e lindjes aktuale | | | | |
| Lindja e 1-rë | 7446 (43.1)* | 695 (42.7) | 1093 (25.5) | 9234 (39.8) |
| Lindja e 2-3-të | 9457 (54.8) | 930 (57.2) | 3197 (74.5) | 13584 (58.6) |
| Lindja e 4-ët | 360 (2.1) | 2 (0.1) | 0 (0.0) | 362 (1.6) |

* Numri absolut dhe përqindja sipas kolonave (në kllapa). Cdo mospërputhje me numrin total vjen për shkak të mungesës së të dhënave.



Grafiku 3. Radha e lindjes aktuale sipas mënyrës së lindjes, 2011-2016

Tabela 7 paraqet peshën mesatare në lindje sipas mënyrës së lindjeve gjatë periudhës 2011-2016. Mund të vihet re që pesha mesatare e fëmijëve të lindur me SC emergjente është në mënyrë domethënëse më e lartë sesa ata të lindur me mënyrë natyrale ose SC elektive.

Tabelë 7. Peshë në lindje sipas mënyrës së lindjes gjatë periudhës 2011-2016

| Variabli | Mënyra e lindjes | | | Vlera e P-së |
|----------------------------|------------------|---------------|-------------|--------------|
| | Lindje natyrale | SC Emergjente | SC elektive | |
| Pesha në lindje (në gramë) | 3372±375* | 3567±386 | 3458±390 | <0.001† |

* Vlera mesatare ± deviacionin standard

† Vlera e P-së sipas testit t të studentit

Tabela 8 paraqet kohëzgjatjen mesatare të shtatzënisë (në javë) sipas mënyrës së lindjeve gjatë periudhës 2011-2016. Mund të vihet re që kohëzgjatja mesatare e shtatzënisë është në mënyrë domethënëse më e lartë tek bebet e lindur me SC emergjente dhe në mënyrë natyrale krahasuar me ata të lindur me SC elektive .

Ndërkohë, proporcione në mënyrë domethënëse më të larta të bebeve që lindën me CS elektive kishin kohëzgjatje të shtatzënisë më pak se 38 javë kurse e kundërta u vu re përsa i përket bebeve me Lindje natyrale dhe CS emergjente lidhur me shtatzënitë që zgjasin 40-41 javë (Tabela 8).

Tabelë 8. Kohëzgjatja mesatare e TTN, HPP dhe shtatzënisë sipas mënyrës së lindjes gjatë periudhës 2011-2016


| Variabli | Mënyra e lindjes | | | Vlera e P-së |
|--|------------------|---------------|-------------|--------------|
| | Lindje natyrale | SC Emergjente | SC elektive | |
| Kohëzgjatja mesatare e shtatzënisë (në javë) | 39.57±0.93* | 39.61±0.83 | 38.93±0.77 | <0.001† |
| Kohëzgjatja e shtatzënisë | | | | <0.001§ |
| 37.0-37.06 javë | | | | |
| 38.0-38.06 javë | 1559 (8.9) ‡ | 88 (5.4) | 525 (12.2) | |
| 39.0-39.06 javë | 1869 (10.7) | 177 (10.9) | 1603 (37.4) | |
| 40.0-40.06 javë | 7115 (40.7) | 740 (45.5) | 1750 (40.8) | |
| | 6954 (39.7) | 622 (38.2) | 411 (9.6) | |

* Vlera mesatare ± deviacionin standard

† Vlera e P-së sipas testit t të studentit

‡ Numri absolut dhe përqindja sipas kolonave (në kllapa). Cdo mospërputhje me numrin total vjen për shkak të mungesës së të dhënave.

§ Vlera e P-së sipas testit hi katror



Grafiku 4. Kohëzgjatja e shtatzënisë sipas mënyrës së lindjes, 2011-2016

6.1.2. Te dhena te lidhura me SEMUNDSHMERINE RESPIRATORE NEONATALE

6.1.2.1 Incidenca e takipnesë tranzitore neonatale (TTN), sipas mënyrës së lindjes, 2011-2016


Tabela 9 paraqet proporcionin e bebeve që bënë takipne tranzitore neonatale (TTN), sipas mënyrës së lindjes. Incidenca e TTN rezultoi 1.6% midis të gjitha bebeve në studim. Takipnea tranzitore neonatale u evidentuan në proporcione në mënyrë domethënëse më të larta të bebeve të lindura me SC elektive (3.9%) krahasuar me bebet e lindura me mënyra të tjera (1.1% tek bebet e lindura natyralisht dhe 1.6% tek bebet e lindura me SC emergjente).

Tabelë 9. Incidenca e takipnesë tranzitore neonatale gjatë periudhës 2011-2016

| Variabli | Total | Mënyra e lindjes | | | Vlera e P-së |
|----------|---------------|------------------|---------------|-------------|--------------|
| | | Lindje natyrale | SC Emergjente | SC elektive | |
| TTN | | | | | |
| Jo | 23032 (98.4)* | 17309 (98.9) | 1601 (98.4) | 4122 (96.1) | <0.001† |
| Po | 382 (1.6) | 188 (1.1) | 26 (1.6) | 168 (3.9) | |

* Numri absolut dhe përqindja sipas kolonave (në kllapa). Cdo mospërputhje me numrin total vjen për shkak të mungesës së të dhënave.

† Vlera e P-së sipas testit hi katror.



Grafiku 5. Incidenca (%) e takipnesë tranzitore neonatale (TTN) tek bebet, sipas mënyrës së lindjes, 2011-2016

6.1.2.2 Incidenca e detresit respirator neonatal gjatë periudhës 2011-2016


Tabela 10 paraqet proporcionin e bebeve që shfaqën detres respirator sipas mënyrës së lindjes. Incidenca e detresit respirator rezultoi 1.0% midis të gjitha bebeve në studim. Detresi respirator u evidentuan në proporcione në mënyrë domethënëse më të larta të bebeve të lindura me SC elektive (2.4%) krahasuar me bebet e lindura me mënyra të tjera (0.7% tek bebet e lindura natyrisht dhe 0.7% tek bebet e lindura me SC emergjente).

Tabelë 10 . Incidenca e detresit respirator gjatë periudhës 2011-2016

| Variabli | Total | Mënyra e lindjes | | | Vlera e P-së |
|-------------------|---------------|------------------|---------------|-------------|--------------|
| | | Lindje natyrale | SC Emergjente | SC elektive | |
| Detres respirator | | | | | |
| Jo | 23171 (99.0)* | 17369 (99.3) | 1615 (99.3) | 4187 (97.6) | <0.001† |
| Po | 243 (1.0) | 128 (0.7) | 12 (0.7) | 103 (2.4) | |

* Numri absolut dhe përqindja sipas kolonave (në kllapa). Cdo mospërputhje me numrin total vjen për shkak të mungesës së të dhënave.

† Vlera e P-së sipas testit hi katror.



Grafiku 6. Incidenca (%) e detresit respirator neonatal, sipas mënyrës së lindjes, 2011-2016

6.1.2.3 Incidenca e hipertensionit pulmonar gjatë periudhës 2011-2016


Tabela 11 paraqet proporcionin e bebeve që shfaqën hipertension pulmonar (HPP) sipas mënyrës së lindjes. Incidenca e hipertensionit pulmonar rezultoi 0.2% midis të gjitha bebeve në studim. Hipertensionit pulmonar u evidentuan në proporcione në mënyrë domethënëse më të larta të bebeve të lindura me SC elektive (0.4%) krahasuar me bebet e lindura me mënyra të tjera (0.1% tek bebet e lindura natyralisht, asnjë bebe e lindur me SC emergjente nuk përjetoi HPP).

Tabelë 11. Incidenca e hipertensionit pulmonar gjatë periudhës 2011-2016

| Variabli | Total | Mënyra e lindjes | | | Vlera e P-së |
|-----------------------|---------------|------------------|---------------|-------------|--------------|
| | | Lindje natyrale | SC Emergjente | SC elektive | |
| Hipertension Pulmonar | 23377 (99.8)* | 17479 (99.9) | 1627 (100.0) | 4271 (99.6) | <0.001† |
| Jo | 37 (0.2) | 18 (0.1) | 0 (0.0) | 19 (0.4) | |
| Po | | | | | |

* Numri absolut dhe përqindja sipas kolonave (në kllapa). Cdo mospërputhje me numrin total vjen për shkak të mungesës së të dhënave.

† Vlera e P-së sipas testit hi katror.



Grafiku 7. Incidenca (%) e hipertensionit pulmonar neonatal , sipas mënyrës së lindjes, 2011-2016

6.1.2.4 Kohëzgjatja mesatare e TTN, HPP dhe shtatzënisë gjatë periudhës 2011-2016

Tabela 12 paraqet kohëzgjatjen mesatare të takipnesë tranzitore neonatale (TTN), hipertensionit pulmonar (HPP) të trajtuar me suport ventilator dhe terapisë me oksigjen në reanimacionin neonatal sipas mënyrës së lindjeve gjatë periudhës 2011-2016. Mund të vihet re që kohëzgjatja mesatare e TTN-së është në mënyrë domethënëse më e lartë tek bebet e lindur në mënyrë normale kurse vlerat mesatare të kohëzgjatjes së HPP-së dhe terapisë me oksigjen në reanimacionin neonatal nuk ndryshonin në mënyrë domethënëse sipas mënyrës së lindjes së bebeve (Tabela 12).

Tabelë 12. Kohëzgjatja mesatare e TTN, HPP dhe shtatzënisë gjatë periudhës 2011-2016

| Variabli | Mënyra e lindjes | | | Vlera e P-së |
|--|------------------|---------------|-------------|--------------|
| | Lindje natyrale | SC Emergjente | SC elektive | |
| Kohëzgjatja e TTN (në orë) | 9.67±4.01* | 8.73±3.11 | 7.95±3.95 | <0.001† |
| Kohëzgjatja e HPP (në ditë) | 1.67±0.48 | - | 1.42±0.81 | 0.305 |
| Kohëzgjatja e O ₂ -terapis reanimacionin neonatal (në ditë) | 2.3±1.12 | 1.50±0.80 | 2.30±1.17 | 0.057 |

* Vlera mesatare ± deviacionin standard

† Vlera e P-së sipas testit t të studentit

6.1.2.5 Të dhëna lidhur me antibiotikoterapinë dhe kohëzgjatjen e qëndrimit në spital

Tabela 13 në vijim paraqet proporcionin e bebeve që patën nevojë për antibiotikoterapi sipas mënyrës së lindjes. Asnjë bebe i lindur me SC emergjente nuk pati nevojë për terapi me antibiotikë por 0.6% e bebeve të lindura në mënyrë natyrale dhe SC elektive kishin nevojë për antibiotikoterapi. Këto ndryshime rezultuan domethënëse nga ana statistikore.

Tabelë 13. Aplikimi i antibiotikoterapisë sipas mënyrës së lindjes

| Variabli | Total | Mënyra e lindjes | | | Vlera e P-së |
|-----------------------|--------------|------------------|---------------|-------------|--------------|
| | | Lindje natyrale | SC Emergjente | SC elektive | |
| Terapi me antibiotikë | 23279 (99.4) | 17389 (99.4) | 1627 (100.0) | 4263 (99.4) | 0.006† |
| Jo | 135 (0.6) | 108 (0.6) | 0 (0.0) | 27 (0.6) | |
| Po | | | | | |

* Numri absolut dhe përqindja sipas kolonave (në kllapa). Cdo mospërputhje me numrin total vjen për shkak të mungesës së të dhënave.

† Vlera e P-së sipas testit hi katror.


Kohëzgjatja mesatare e qëndrimit në spital, e shprehur në numër ditësh, paraqitet në Tabelën 14. Kohëzgjatja mesatare e qëndrimit në spital rezultoi në mënyrë domethënëse më e lartë për bebet e lindura me SC elektive (mesatarisht 3.1 ditë qëndrim në spital) dhe bebet e lindura me SC emergjente (mesatarisht 3 ditë në spital) krahasuar me bebet e lindura në mënyrë natyrale (mesatarisht 1.59 ditë në spital).

Tabelë 14. Kohëzgjatja mesatare e qëndrimit në spital sipas mënyrës së lindjes, gjatë periudhës 2011-2016

| Variabli | Mënyra e lindjes | | | Vlera e P-së |
|---|------------------|-------------|---------------|--------------|
| | Lindje natyrale | SC Elektive | SC emergjente | |
| Kohëzgjatja e qëndrimit në spital (në ditë) | 1.59±0.59* | 3.10±0.49 | 3.02±0.16 | <0.001† |

* Vlera mesatare ± deviacionin standard

† Vlera e P-së sipas testit t të studentit



